



# PROGRAMI I ZONËS FUNKSIONALE SHIJAK

Analizë e të dhënave në nivel vendor  
Zhvillimin Ekonomik  
Shërbimet Publike



Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Zhvilluar nga:  
Studio D

Publikuar nga:  
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

**HELVETAS Swiss Intercooperation** | Albania  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova",  
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri  
[www.dldp.al](http://www.dldp.al) | [www.km.dldp.al](http://www.km.dldp.al)

## Përbajtja

- **Pabarazitë e zhvillimit në qarkun e Durrësit:**
  - Zona e Shijakut dhe pabarazitë e saj të brendshme dhe të jashtme;
- **Përshkrim i shkurtër mbi traditën dhe historinë e zonës;**
- **Linja të përgjithshme të analizës dhe kufizimet e ndeshura;**
- **Sa funksionale është zona e Shijakut ose përpjekje për identifikim të qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik në zonë:**
  - Sektorët e traditës në zonën e Shijakut;
  - Sektorët me rëndësi në zonën e Shijakut si përgjigje e synimit strategjik për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar;
    - ÷ Bujqësia
    - ÷ Agropërpunimi
    - ÷ Shërbime të ofruara nga NVM
    - ÷ Turizmi familjar dhe agroturizmi
  - Faktorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik vendor të zonës së Shijakut;
    - ÷ Aplikim i metodës SWOT
  - Analizë e aktorëve vendorë - përcaktues të ecurisë së zhvillimit vendor;
  - Politikat sektoriale kombëtare dhe përkthimi i tyre në nivel vendor kundrejt nevojave të zonës së Shijakut;
  - Analizë e strukturës organizative aktuale dhe skema e sugjeruar për njësinë e reformuar të qeverisjes vendore
  - Rekomandime për masa afatmesme;
- **Shërbimet publike në Shijak si vlerësim i parimeve të qeverisjes dhe autonomisë së saj:**
  - Shërbime publike të nevojshme në zonën e Shijakut në përgjigje e synimit strategjik për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar;
    - ÷ Mbetjet urbane
    - ÷ Ujësjellësi dhe kanalizimet
    - ÷ Transporti publik
  - Faktorë që ndikojnë në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike në nivel vendor në zonën e Shijakut;
- **Përfundime dhe rekomandime strategjike mbi qeverisjen dhe zhvillimin ekonomik vendor në zonën e Shijakut;**
- **Referanca;**
- **Anekse;**

#### ▪ **Pabarazitë e zhvillimit në qarkun e Durrësit:**

Mungesa e të ardhurave nga punësimi, dhe niveli i varfërisë, ndryshojnë jo vetëm në nivel rajonal, por edhe brenda një rafoni. Shtrirja e analizës në hapësirën brenda një rafoni siç është Qarku i Durrësit, dhe krahasimi i treguesve midis zonave urbane me ato rurale, evidenton një pabarazi më të dukshme në nivelit të jetesës midis tyre. Përveç evidentimit të faktit që pabarazia në nivelin e jetesës është prezente si në zonat rurale, periurbane edhe në ato urbane, analizat kanë treguar edhe se në secilën prej këtyre njësive administrative ka një shpërndarje të pabarabartë gjeografike të familjeve në nivelin e varfërisë absolute. Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, Shqipëria, është karakterizuar nga një nivel më i lartë i varfërisë absolute në zonat rurale, por në të njëjtën kohë edhe për një prezencë të varfërisë absolute në qytetet kryesore të vendit. Varfëria në Shqipëri karakterizohet nga dimensione hapësinore dhe rafionale, ku sipas të gjitha përkufizimeve të varfërisë, zonat rurale janë vazhdimishit më të varfëra se pjesa tjetër e vendit. Që në vitin 1996, një studim i Bankës Botërore e karakterizonte varfërinë më shumë si një fenomen rural sesa urban, pasi kishte evidentuar se rrëth 90% e numrit të popullsisë së varfër në Shqipëri, jetonte në zona rurale.

Sipas gjetjeve të rezultuara nga studimi mbi pabarazitë rafionale (UNDP, 2010) del në pah diferencimi i qartë rafonal midis ekstremeve të zhvillimit që janë qarqet më të zhvilluara të Tiranës dhe Durrësit dhe ato më pak të zhvilluara të Dibrës dhe Kukësit. Pjesa tjetër e qarqeve karakterizohet nga zhvillime të ndërmjetme që përfaqësohen nga tregues që luhaten në vlera mesatare. Kjo pabarazi zhvillimore shoqërohet me migrimin e popullsisë që sic dihet, shkakton probleme si në zonat e braktisura ashtu edhe në ato të destinacionit.

Ndonëse në rang vendi, në rrafshin demografik, konsiderohet si një përparësi popullsia e re në krahasim me vende të tjera të Bashkimit Evropian ku Shqipëria aspiron të hyjë, nga ana tjetër, në kushtet e mungesës së oportuniteteve për punësim ky tipar demografik cilësohet si një disavantazh vecanërisht për rafonet periferike ku ende nuk ndihet dora e shtetit për të stimuluar zhvillimin. Aspekte problematike konsiderohen edhe emigrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar dhe çpopullimi i vazhdueshëm i shumicës së qarqeve të vendit, sidomos në zonat periferike.

*Tabela Nr. 2 Të dhëna të përgjithshme mbi situatën sociale, 2014*

NjQV	Familje që	Individë që jetojnë me	Të papunë	Në %
	jetojnë me	ndihmë ekonomike, në		
ndihmë	% ndaj popullsisë			
ekonomike				
<b>Gjepalaj</b>	17	2.21	205	7
<b>Maminas</b>	9	0.9	265	7
<b>Shijak</b>	192	11.4	1.100	14
<b>Xhafzotaj</b>	10	0.36	947	9

Burimi: Census 2011; Të dhëna administrative nga qarku dhe NjQV, Statistika 2014.

- Zona e Shijakut dhe pabarazitë e saj të brendshme dhe të jashtme;

Me një bazë të fuqishme bujqësore, pjesa më e banuar e zonës funksionale të Shijakut ka agrobiznesin si një shtyllë themelore të ekonomisë lokale, me potencial të pashfrytëzuar për të furnizuar tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Rajoni ka gjithashtu një potencial të fuqishëm për zhvillimin e turizmit, me një kombinim


të bukurisë natyrore të vijës bregdetare dhe me një trashëgimi arkeologjike që nga kohët Greke dhe Romake. Vija bregdetare kanë gjithashtu burime për zhvillimin e një industrie të rëndësishme turizmi kur të krijohet infrastruktura e duhur dhe të ngrihet promociioni i strukturuar i turizmit.

Në këtë komponent të analizës vëzhgohet një segment kërkimor, konkretisht demografia dhe karakteristikat e forcës së punës, në kontekstin e situatës së përgjithshme sociale. Njësitë e përzgjedhura për studim, përkatesisht Bashkia Shijak dhe Komunat Xhafzotaj, Gjepalaj e Maminas, bëjnë pjesë në rrëthin e Durrësit e qarkun e Durrësit. Nga pikëpamja gjeografike, të katër njësitë e përzgjedhura shtrihen në Shqipërinë e mesme, në zonë kodrinore e fushore, pranë ultësirës së Adriatikut. Përveç klimës të përshtatshme mesdhetare, zona përshkohet nga lumi Erzen dhe lumi Ishëm, duke siguruar kushte të përshtashme për zhvillimin e kulturave bujqësore.

Komuna Xhafzotaj dhe Bashkia Shijak kanë popullsi më të madhe në krahasim me dy komunat e tjera, me një dendësi rrëth 100 banorë për  $\text{km}^2$ , afersisht të njëjtë me dendësinë mesatare të vendit. Zona e studjuar historikisht ka qenë e ndikuar nga migracioni. Në të kaluarën e largët emigracioni i popullsisë boshnjake ndikoi në rritjen e popullsisë së zonës, ndërsa pas viteve 90-të, emigracioni i popullsisë shqiptare jashtë vendit ndikoi në ndrshimin e numrit dhe strukturën e forcave të punës. Figura 1 paraqet zhvillimin ekonomik të katër njësive të studjuara në krahasim me nivelin e varfërisë.

*Figura 1: Harta e zhvillimit ekonomik të zonës funksionale.*

## Zhvillimi ekonomik



### Legjenda

Intensiteti i ngjyrave paraqet vlerat nga më e ulta tek më e larta.

Vlerësimi i varfërisë: Përqindja e popullsisë që jeton me ndihmë ekonomike



Vlerësimi i bizneseve: Raporti i bizneseve për fryshtë



▪ Përshtimë i shkurtër mbi traditën dhe historinë e zonës;

Shijaku ne historikun e tij perfaqesohet si vendbanim i hershem, ku ne harten e disa vendbanimeve parahistorike te Shqiperise gjendet edhe "guri unik militar" i tij, i gjetur ne afersi te fshatit Sallmone prane lumit Erzen per gjate rruges Dyrrachium (Durres)-Lisus (Lezhe)dhe qe i takon kohes se paleolitit te larte (40.000-6000 vjet p.e.s). Historia deshmon se pas themelimit te Durresit ne vitin 627 para Krishtit, nje nder qendrat e banuara ka qene edhe Shijaku si pjese perberese e fisit te taulanteve te cilit si qender te territorit te tyre kishin Durresit. Me kete emer qe ka sot Shijaku njihet qe para mesjetes. Toponimi gjeografik i Shijakut eshte me prejardhje fetare nga Shen Jakku ku fillimisht eshte quajtur Shen Jak, Shenjak, Shejak, Shinjak e me pas Shijak. Ne nje harte te vitit 1861 , Shijaku rezulton me mbishkrimin: Schak.

Shijaku ne fizionomine e tij te sotme ka ardhur me themelin e tij ne vitin 1880 nga Sali bej Deliali, fillimisht si nje vendbanim me karakter rural(katund)por me nje prespektive qytetare, me hanin e tij, furren e bukes,kafenene, xhamine etj. Pas vitit 1880, ne Shijak vendosen muhaxhiret boshnjake te cileve Sali beu u ofroi si vendbanime dy katunde, te cilat me pas do te merrnin emrin

Koxhas dhe Borake te cilat ekzistojne edhe sot. Rreth viteve 1908 Shijaku shikohet si qender atraktive dhe terheq banore edhe nga Tirana, Kruja dhe Shengjergji te cilet vendosen ety dhe ndertojne banesat dhe dyqane perreth pazarit.

Fizionomine e plote si qytet, Shijaku e mori pas rindertimit te tij mbi bazen e projektit francez rrerh vitit 1930, deshmi e cila na vjen edhe nga fotot e fotografave me fame, vellezerve Marubi. Pas vitit 1400 Shijaku me katundet perreth tij del i rregjistruar si pjese e sanxhakut te Shqipërise nen timarin e Skurrjes. Ne vitin 1910 Shijaku ishte kaza (nenprefektura) dhe kishte nen adminstrim tre nahije (komuna). Shijaku vete perbehej nga tre lagje: "Lagjia e Re", "Lagjia e Vjetër" dhe "Lagjia Erzen". Ne vitet '40 Shijaku numeronte 216 shtepi me 1352 banore ndersa ne katundet e perfshira ne nenprefekturen e Shijakut (72 katunde) numeronte 3476 shtepi dhe 16954 banore. Sot Shijaku numeron rrerh 12900 banore.

Bashkia Shijak ndodhet ne pjesen e Shqipërise se mesme dhe ben pjese ne Qarkun administrativ te Durresit dhe kufizohet me komunat Xhafzotaj, Gjepalaj dhe Maminas. Ne perberjen e saj ka perkatesisht 3 lagje: 1-Lagjia Popullore, 2-Lagjia Erzen, 3-Lagjia Kodra. Siperfaqja e bashkise eshte 3,5 km<sup>2</sup>. Shijaku ka nje shtrirje te favorshme gjeografike me nje largesi prej 11km nga qyteti i Durresit 25 km nga aeroporti kryesor I vendit "Nene Tereza" dhe 38 km nga qyteti i Tiranes,

Nga statistikat del qe popullsia e Shijakut nga viti 2003-2007 ka nje rritje mesatare te popullsise prej 1% ne vit dhe kjo rritje vjen si pasoje e ardhjes se familjeve te reja nga veriu i vendit apo nga zonat rurale ne afersi te Bashkise se Shijakut.

Ne qytetin e Shijakut funksionon "Qenda e Kultures" ne varësi të Bashkisë së qytetit e cila ka si funksion organizimin e jetës dhe aktiviteteve kulturore ne qytet. Si objekt kulture Shijaku disponon "Pallatin e Kultures" që administrohet nga kjo qender dhe i cili ka një kapacitet prej 570 vendesh te ulura dhe me një akustike shume të mirë. Në qytet funksionon muzeu por eshte ne nje gjendje te mjerueshme per shkak te investimeve te pakta. Shijaku eshte nje qytet me nje tradite te hershme sportive. Klubi sportiv Erzeni eshte krijuar qe ne vitin 1931. Shijaku si objekte sportive disponon nje stadium futbolli dhe ka nje projekt per ndertimin e nje pallati sporti.

#### Personalitete te njohura te Zones

*Xhelal Deliali, firmtar i Deklarates se Pavaresise se Shqiperise*

*Ymer bej Deliali, firmtar i Deklarates se Pavaresise se Shqiperise*

*Ibrahim Efendi, firmtar i Deklarates se Pavaresise se Shqiperise*

#### ▪ Linja të përgjithshme të analizës dhe kufizimet e ndeshura;

Analiza e paraqitur në këtë raport kërkon të hulumtojë dhe të sqarojë dilemën mbi ndikimin që zonat funksionale kanë në përmirësimin e shërbimeve të dobishmërisë publike. Si e tillë, analiza udhëhiqet nga hipotezat e mëposhtme:

- i. Procesi i decentralizimit të qeverisjes vendore ka një tërësi ndikimesh tek qytetarët në nivel lokal, për aq kohë sa vendimet që lidhen me jetën e përditshme të njerëzve transferohen

gradualisht nga niveli qendror në nivel vendor. Megjithatë, duhet të theksohet se përfitimet e tyre nga procesi i decentralizimit maksimizohen kur qeverisja vendore përveç kompetencave zotëron edhe mjetet për realizimin e tyre.

- ii. Pavarësisht faktit se decentralizimi është një objektiv kyç kombëtar; krijimi i zonave funksionale ai nuk duhet që të zbatohet duke kopjuar modelet ose duke u mbështetur vetëm në tregues të formës. Ajo duhet të marrë parasysh pabarazitë rajonale në burimet natyrore, si dhe kapacitetet njerëzore, duke marrë në konsideratë vlerësimin e varfërisë dhe indikatorët e mirëqenies sociale për çdo rajon/lokalitet.
- iii. Transparenca, përgjegjësia dhe pjesëmarrja, janë kushtet kryesore për suksesin e reformës së decentralizimit. Rritja e transparencës në nivel rajonal dhe lokal, kontribuon në rritjen e kredibilitetit të qeverisjes rajonale/vendore dhe autoriteteve kombëtare.

Metodologjia e përdorur është një kombinim i analizës së informacionit statistikor zyrtar dhe grupeve të fokusuar në nivel lokal dhe rajonal në drejtimet që vijojnë:

- ÷ Burimet Njerëzore dhe Administrimi.
- ÷ Të dhëna mbi infrastrukturën e NjQV.
- ÷ Të dhëna ekonomike dhe sociale mbi NjQV.
- ÷ Të dhëna mbi mirëqeverisjen dhe pjesëmarrjen qytetare.
- ÷ Informacioni zyrtar statistikor përfshin të dhëna nga Census, të dhëna statistikore nga dega e thesarit Durrës, zyra e Punës Durrës, seksionet e Ndihmës dhe Përkujdesit Shoqëror në secilën nga njësitë e përzgjedhura për studim, Këshilli i qarkut Durrës si edhe Observatori Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve.
- ÷ Informacioni i përpunuar nga diskutimet me grupe të fokusuar përfshin të katër njësitë, në të cilat u realizuan nga dy diskutime, gjithsej tetë. Diskutimet u organizuan mbi bazën e një pyetsori me pyetje gjysëm të strukturuara të përgatitur më parë.

Rezultatet e analizës së informacionit janë përbledhur dhe organizuar sipas kapitujve përkatës. Analiza është ndërtuar mbi bazën e modeleve krahasimore të asaj që pasqyrojnë të dhënat ekonomike dhe sociale për njësitë administrative të përzgjedhura si objekt studimi si edhe kriterieve të përcaktuara nga qeveria për organizimin e zonave funksionale.

Pavarësisht se krijimi i zonave funksionale është një vendim politik si komponent i reformës territoriale, ai është ngushtësish i lidhur me zhvillimin ekonomik e social dhe kushtëzohet nga faktorë ekonomikë e sociale. Këtë konkluzion e provon edhe vetë përkufizimi i zonave funksionale, i pëershruar më lart. Zona funksional e analizuar në këtë raport është konsideruar në aspektin e “efektivitetit në raport me shërbimet e dobishmërisë publike”. Për rrjedhojë, në pjesët në vijim të

punimit, krijimi i zonave funksionale do të analizohet nën këndvështrimin e ligjit që udhëheq ekonominë e tregut të lirë, i ashtuquajturi ligji i kërkesës dhe ofertës.

Burimet natyrore, infrastruktura e kapacitetet institucionale, mundësitë e përdorimit të tyre dhe qeverisja vendore janë përfshirë tek ”oferta”, ndërsa nevojat, karakteristikat e kapitalit njerëzor e social janë përfshirë tek ”kërkesa”. Kjo qasje e re e analizës krijon më shumë hapësirë jo vetëm për vlerësimin efektiv të alternativave të zonave funksionale, por edhe shërben për të siguruar informacionin fillestare mbi drejtimet e zhvillimit të zonave funksionale në të ardhmen.

- **Sa funksionale është zona e Shijakut ose përpjekje për identifikim të qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik në zonë:**

Pjesa me e madhe e sipërmarrjeve në zonë janë te vogla, me vetem 4% te tyre qe punesojne me shume se 10 punetore. Sipermarresit kane synuar qe te kalojne ne biznese te vogla me pune intensive si rezultat i struktures se ulet te pagave ne Shqiperi. Aktivitete te vogla ne prodhimin e kepuceve dhe te veshmbathjeve kane rezultuar fitimprurese kryesisht per kompanite e vogla qe nenkontraktojne perpunimin per firmat e huaja. Megjithate, sherbimet financiare si bankat dhe sigurimet, si dhe sherbimet mbi informacionet per biznesin, ende janë te pamjaftueshme per një ekonomi te zhvilluar. Ne total, rreth 53% e bizneseve ne Shijak janë në shitjet me pakice; 11% janë ne sektorin e sherbimeve si hotelet, restorante dhe bare; 18% janë ne transport; 11 % ne prodhim; 3% ne ndertim; dhe vetem 4% ne perpunim bujqesor.

- Sektorët e traditës në zonën e Shijakut;

Nga diskutimet me grupe të fokusuara në komunat Gjepalaj, Maminas dhe Xhafëzotaj si dhe përmes intervistave me banorë të Bashkisë Shijak konfirmohet se tradita në zonë përqendrohet kryesisht në bujqësi dhe në tregtinë e mallrave. Vlen të theksohet se sipas burimeve historike vendore dhe të huaja qyteti i Shijakut figuron në regjistrin kadastral të perandorisë otomane të vitit 1431-32.

Bujqësia është konsideruar si sektor i rëndësishëm për ekonominë dhe mirëqënien e zonës e ndihmuar edhe nga kushtet e klimës dhe cilësia e lartë e tokës.

- Sektorët me rëndësi në zonën e Shijakut si përgjigje e synimit strategjik për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar;

- ÷ **Bujqësia**

Megjithë ndryshimet e shpeshta të orientimit të ekonomisë së qytetit të Shijakut dhe të komunave përreth sektori bujqesor mbetet i një rendesie madhore per ekonomine e per gjithshme të zonës. Pra, ka patur një rerie te lehte ne vitet e fundit, si rezultat i një rimekembjeje ne sektorin industrial dhe një rritjeje ne ate te ndertimit, por përsëri kontributi relativ i bujqesise ne zonës është ende i larte. Megjithë arritjet e deritanishme, ende ka shume probleme qe lidhen me bujqesine dhe

jeten rurale. Sistemet e prodhimit mbeten ato tradicionalet, rendimenti i ulet, shume ferma jane te teper te vogla dhe te copezuara per te qene te qendrueshme, infrastruktura fizike eshte e varfer, dhe aktiviteti i sektorit privat duhet te plotesoje boshllekun e krijuar nga mosfunkcionimi i skemave dhe strukturave mbështetëse të agro-industrise dhe marketingut. I njejtë shqetesim qendron edhe per degradimin e madh mjesdisor. Keshtu, megjithese mbreselenese, ndryshimet e ndodhura deri me sot jane vetem fillimi i procesit te transformimit. Bujqesia ne Shijak dominohet nga fermeret e vegjel, te cilet prodhojne si per konsum familjar ashtu edhe per treg. Tregu mbetet ende i pakonsoliduar megjithëse në të gjen tregtare private, agro-perpunues dhe furnizues inputesh.

Rimekembja e shpejte e fermerëve ne fillim te tranzacionit (vitet 90), ndodhi pasi keta fermere e pershtaten prodhimin bujqesor me situaten lokale. Ne fillim, fermeret synuan te prodhonin sasine e nevojshme te drithit, kulturave kryesore bujqesore, per konsum individual, dhe mbështeteshin ne blegtori dhe/ose perimet per te siguruuar te ardhura te kufizuara ne kesh. Kulturat bujqesore prodhoheshin ne kushtet e nje perdonimi te kufizuar te farerave te permiresuara, pleherave dhe inputeve te tjera, megjithese se fundi ka patur nje permiresim ne situaten e furnizimit me inpute, pasi tregtaret private kane levizur per t'a mbushur kete boshlek. Siperfaqja e kultivuar me grure ka ndryshuar gjate periudhes se tranzacionit. Qe prej 1994, ka pasur nje renie konstante te sasise se grurit te mbjelle, duke qene se fermeret i kane perqendruar burimet e tyre ne aktivite te tjera. Kjo renie ka ndodhur vecanerisht ne zonat kodrinore, ku gruri kultivohej ne toke te papershtatshme per te permbushur synimet kombetare per veteqendrueshmeri. Rendimentet mesatare tani jane te ngashme me ato te arritura perpara reformave, pjeserisht per faktin qe tashme gruri kultivohet ne toka me te mira.

Ka patur edhe nje shtim te siperfaqes dhe prodhimit te perimeve, vecanerisht ne rajonet e uleta me akses te kenaqshem ne tregjet e zonave urbane. Ka patur nje rritje edhe ne prodhimin e bimeve foragjere per ushqimin e blegtorisë ne te gjitha rajonet e vendit. Perpara vitit 1990, pothuajse e gjithe siperfaqja e tokes bujqesore rrith 1200 ha ishte e mbjelle me kultura fushe apo peme frutore. Megjithate, sot vetem 51% e tokes bujqesore eshte e mbjelle; Shkaqet kryesore kishin te benin me mungesen e sherbimeve ujitese dhe largesine nga fshati. Rendesia relative e prodhimit blegtoral eshte rritur gradualisht qe prej reformave, me nje kontribut ne vleren e prodhimit te rritur në 50%. Prodhimi blegtoral pershtatet mire me sistemin e fermave te vogla dhe ka nje funksion te rendesishem per mbrojtjen sociale. Ekonomite private synojne kryesisht te prodhojne aq qumesht dhe mish sa te plotesojne nevojat e tyre per konsum, dhe te mbetet nje pjese tjeter suplementare, e cila shitet ku te mundet ne tregjet lokale apo ne fabrikat e vogla te perpunimit, te cilat shtohen dita dites. Karakteri i vogel i prodhimit blegtoral ilustrohet me të dhënat e mbledhura në komuna dhe strukturat rajonale përgjegjëse për bujqësinë.

Te tjere faktore qe shpjegojne kete rritje jane toka e lire e pershtatshme per foragjere; mundesia per te rritur numrin e gjese se gjalle pa shpenzime te larta; fuqia punetore e lire per t'u perkujdesur per gjene e gjalle; aftesia per te siguruar te ardhura te rregullta nga produktet blegtorale; dhe kerkesa ne rritje per produktet blegtorale.

Megjithate, interesi ne rehabilitimin e prodhimit te pemeve frutore, vecanerisht molleve, ka ardhur duke u rizgjuar. Edhe prodhimi i ullirit eshte rritur disi, gje qe mund t'i atribuohet pjeserisht ringritjes gjate koheve te fundit te fabrikave te vogla te perpunimit te vajit te ullirit. Gjithashtu, ka nje interes te konsiderueshem ne rritjen e prodhimit te pjergullave, dhe ne fakt vihet re nje rritje e vogel e siperfaques se mbjelle dhe nje rritje akoma me e madhe ne prodhim si rezultat i menaxhimit me te mire te tokes ne funksion te dhenies se rendimenteve me te larta. Ne te kundert, prodhimi i agrumeve ka vazhduar te bjere, pjeserisht pasi nuk ka mundur te konkuroje me cilesine me te larte te frutave qe vijnë nga Italia dhe Greqia.

*Numri i sipërmarrjeve në sektorin bujqësi – blegtori në zonë*

Viti	Nr	Komune/Bashki	Nr tot i fermave	Ferma bujqesore	Ferma Blegtorale	Ferma mixe
	1	Shijak	139	14	15	110
	2	Xhafzotaj	2611	766	545	1300
	3	Maminas	1255	40	15	1200
	4	Gjepalaj	1086	16	140	930
2006	Totali		5091	836	715	3540
	1	Shijak	135	10	18	107
	2	Xhafzotaj	2580	750	550	1280
	3	Maminas	1278	40	15	1223
	4	Gjepalaj	1052	12	134	906
2007	Totali		5045	812	717	3516
	1	Shijak				
	2	Xhafzotaj	2672	780	562	1330
	3	Maminas	1292	46	18	1228
	4	Gjepalaj	1092	16	146	930
	Totali		5211	852	745	3614
	1	Shijak	154	10	24	120
	2	Xhafzotaj	1416	750	530	136
	3	Maminas	1319	35	17	1267
	4	Gjepalaj	1110	16	124	970
2009	Totali		3999	811	695	2493
	1	Shijak	148	20	18	110
2010	2	Xhafzotaj	2470	760	530	1180

	3	Maminas	1332	46	26	1260
	4	Gjepalaj	1084	14	140	930
	Totali		5034	840	714	3480
	1	Shijak	148	20	18	110
	2	Xhafzotaj	2470	760	530	1180
	3	Maminas	1332	46	26	1260
	4	Gjepalaj	1084	14	140	930
2011	Totali		5034	840	714	3480
	1	Shijak	181	28	23	130
	2	Xhafzotaj	2410	800	500	1110
	3	Maminas	1335	45	23	1267
	4	Gjepalaj	1051	16	145	890
2012	Totali		4977	889	691	3397
	1	Shijak	181	28	23	130
	2	Xhafzotaj	2410	800	500	1110
	3	Maminas	1335	45	23	1267
	4	Gjepalaj	1051	16	145	890
2013	Totali		4977	889	691	3397
	1	Shijak	150	10	19	121
	2	Xhafzotaj	2638	765	562	1311
	3	Maminas	1280	42	18	1220
	4	Gjepalaj	1101	16	146	939
2014	Totali		5169	833	745	3591

*Tregjet në zonën e studimit*

Viti	Nr	Komune/Bashki	Numri i Tregjeve	Treg bujqesor	Treg Blegitoral	Tregje mixe
	1	Shijak	3	1	1	1
	2	Xhafzotaj	0	0	0	0
	3	Maminas	0	0	0	0
	4	Gjepalaj	0	0	0	0
2006-2013	Totali		3	1	1	1
	1	Shijak	3	1	1	1
	2	Xhafzotaj	1	1	1	1
	3	Maminas	0	0	0	0
	4	Gjepalaj	0	0	0	0
2014	Totali		4	2	2	2

*Të dhëna mbi grumbulluesit*

Viti	Komune/Bashki	Nr. total i grumbulluesve	Grumbullues të produkteve bujqësore	Grumbullues të produkteve blegtoriale	Grumbullues të produkteve (mikse)
2006 - 2009	Shijak	2		2	
	Xhafzotaj	3		3	
	Maminas	2	1	1	
	Gjepalaj			2	
	Totali	7	1	8	
	Shijak				
	Xhafzotaj				
	Maminas	2	1	1	
	Gjepalaj	2	1	1	
2010 - 2013	Totali	4	2	2	
	Shijak	2		2	
	Xhafzotaj	3		3	
	Maminas	2	1	1	
	Gjepalaj			2	
2014	Totali	7	1	8	

#### ÷ Agropërpunimi

Vetem një pjese e vogel e prodhimit vendas perpunohet nga një industri e vogël agro-perpunuuese, e cila ze puneson 8 perqind te fuqise punetore ne nivel kombtar. Aktualisht, ekzistojne rrëth 6sipërmarrje te cilat operojne me investime në përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale perpunimin e vajit te ullirit, qumeshtit dhe mishit. Zhvillimi i potencialeve agro-perpunuuese do te kete rol vendimtar per permiresimin e metejshem te bujqësise në komuna. Industria agro-perpunuuese sherben si një instrument kryesor dhe i qendrueshem per prodhimin bujqësor si dhe ofron mundesi per punesim ne këto komuna. Marketingu i produkteve te perpunuara dhe te një cilesie te larte do te rrise mundesine qe produktet e Shjakut te konkurojnë ne tregun kombëtar dhe/ose të rajonal dhe te gjejë hapesira të reja tregtare.

Prodhimi organik me siguri do te arrije qe te zoteroje një segment ne treg. Megjithate, para se të synohen tregje te reja, duhet te permiresohet dhe te mbahet e qendrueshme cilesia e produkteve; e per pasoje edhe standartet e cilesise duhen te percaktohen dhe te imponohen per zbatim. Pjesa me e madhe e fabrikave perpunuuese jane te vogla, dhe impakti i tyre ne marketing, zakonisht paraqitet shume i lokalizuar. Ekspansioni pengohet nga mungesa e kapitalit, ekpertizes, dhe kosto e larte e grumbullimit te produkteve. Zhvillimi i metejshem i industrise agro-perpunuuese do te jete vendimtar per një lidhje te permiresuar te fermereve me tregjet dhe një rritje te vleres se produkteve lokale. Marketingu kryhet nga disa tregtare private dhe nepermjet tregjeve lokale në Tiranë dhe Durrës. Fuqia negociuese e fermereve eshte e vogel si pasoje

e mungeses se informacionit mbi cmimet dhe mundesite e kufizuara per shitje. Do te jetë e rendesishme qe te permiresohet infrastruktura e tregjeve, per te funksionuar ne menyre me eficiente, si dhe te garantohet mirembajtja e tregjeve. Sa i takon grumbulluesve në zonën e studimit operojnë momentalisht 8 të tillë. Kryesisht grumbullojnë produktet bujqësore. Ndërkokë që së fundmi ka iniciativa për ngritjen e kantinave të verës sidomos në komunën e Maminasit ku kjo kulturë bashkë me ullirin janë kulturat prioritare. Referuar potencialeve prodhuese të zonës keto pika frumbullimi janë të pamjaftueshme në kapacitete dhe numër. Marrdhënet midis aktorëve janë të paformalizuara nga ana ligjore (pa kontrata). Këto kushte detyrojnë fermerin të shkojë individualisht në tregjet më pranë tij (Tiranë Durrës), cka në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në kostot e tyre. Transporti dhe infrastruktura rrugore në brendësi të komunave lënë shumë për të dëshiruar.

*Sipërmarrjet agropërpunesë në zonën e Shjakut gjatë viteve 2006-2014*

Viti	Komune/Bashki	Nr. total i përpunesve	Përpunes të produkteve bujqësore	Përpunes të produkteve blegtorale	Përpunes të produkteve (mikse)
	Shjak				
	Xhafzotaj				
	Maminas				
	Gjepalaj				
2006	Totali				
	Shjak	2		1	1
	Xhafzotaj	4	4		
	Maminas				
	Gjepalaj				
2007-2009	Totali	6	4	1	1
	Shjak	2		1	1
	Xhafzotaj				
	Maminas				
	Gjepalaj				
2010-2013	Totali	2		1	1
	Shjak	2		1	1
	Xhafzotaj	4	4		
	Maminas				
	Gjepalaj				
2014	Totali	6	4	1	1

#### ÷ Shërbime të ofruara nga Ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)

Aktualisht, ekonomia rurale jobujqesore kufizohet ne ndertimet e vogla, sherbime te vogla teknike dhe profesionale si dhe tregtine e vogel. Punedhenesit ne sektorin e sherbimeve zakonisht perfaqesohen nga biznese familjare, te cilat jane te vogla dhe me pak mundesi per hapje vendesh pune. Pervec kesaj, puna ka tendence te jete e rastesishme, me nderprerje dhe me pagese te ulet. Ato pak vende pune qe krijojen duken qe te krijojnë pak mundesi ose aspak ne drejtim te mesimit te aftesive te reja, duke e disavantazhuar edhe me tej fuqine punetore rurale pothuajse te paformuar. Nga ana tjeter, ekonomia rurale jobujqesore siguron vetem mallrat dhe sherbimet baze te jeteses, dhe mbeshtetet me shume ne kode lidhjesh farefisnore dhe tradicionale te reciprocitetit nderpersonal sesa ne praktikat moderne kontraktuale. Ekonomise rurale jobujqesore i mungojne investimet dhe iniciativa e nevojshme, te cilat sot jane te orientuara drejt zonave te uleta urbane dhe gjysme-urbane, aty ku jane shfaqur ritmet me te shpejta te rritjes gjate viteve '90. Kjo ka cuar ne nje migrim ne shkalle te gjere nga zonat rurale, kryesisht te anetareve meshkuj me aktive te familjes, te cilet terhiqen per punesim ne zonat urbane dhe jashte shtetit. Per pasoje, popullsia rurale po dominohet ne menyre progresive nga grata, te moshuarit dhe te paformuarit nga ana profesionale, duke e ngushtuar ne menyre te konsiderueshme bazen e

burimeve njerezore per zhvillimin e Ekonomise Rurale Jobujqesore. Ekonomia Rurale Jobujqesore ne Shqiperi ka vuajtur gjithashtu edhe nga mungesa e rregullimeve institucionale te nevojshme per zhvillim. Vihen re boshllqe te medha institucionale ne arsim dhe trajnimin per aftesi teknike dhe drejtimin e biznesit, aksesit ne sherbimet financiare, koordinimit me pushtetin lokal dhe organizatat e shoqerise civile; dhe dekretimin, perhapjen dhe venien ne funksionim te nje organi i cili te kerkoje respektimin e ligjit tregtar. Fuqia punetore

rezulton me nje ulje te vazhdueshme te aftesive, si pasoje e migracionit, moshimit dhe mungeses se arsimit dhe formimit profesional te te rinjve.

Njësitë e përgjedhura në rajonin i Durrësit, në një nga rajonet më të pasura në burime natyrore dhe njerëzore, nuk demonstronë të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm. Nga pikëpamja gjeografike, të katër njësitë e përgjedhura shtrihen në Shqipërinë e mesme, në zonë kodrinore e fushore, pranë ultësirës së Adriatikut. Përveç klimës të përshtatshme mesdhetare, zona përshkohet nga lumi Erzen dhe lumi Ishëm, duke siguruar kushte të përshtashme për zhvillimin e kulturave bujqësore.

Në zonën funksionale Shijak (Bashkia Shijak dhe Komunat Xhafzotaj, Gjepalaj e Maminas) veprojnë 1,381 ndërmarrje aktive, rrëth 16 përqind e ndërmarrjeve të të gjithë rrëthit. Indeksi mesatar i PBB është më i lartë se sa i Indeksi mesatar i PBB për qarkun (0,615:0,606)<sup>1</sup>. Sipas të njëjtë burim informacioni, edhe Indeksi mesatar i Zhvillimit Njerëzor në zonën funksionale të marrë në analizë është më i lartë se sa Indeksi mesatar i Zhvillimit Njerëzor për qarkun. (0,755:0,751).

<sup>1</sup> Strategjia e Zhvillimit të qarkut Durrës, 2005-2015, Tab. 1.17.

Megjitahtë secila prej njësive që përbëjnë zonën funksionale Shijak, nuk demonstrojnë të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm. Në të katër njësitë e përgjedhura situata ekonomike paraqitet e vështirë, ndërsa investimet në nxitjen e punësimit, sipërmarrjen, biznesin e vogël e të mesëm si edhe infrastrukturën, të kufizuara. Aktiviteti kryesor mbetet bujqësia sidomos në komunat Xhafzotaj dhe Maminas, ndërkoq që komuna e Gjepalajt kryesisht fokusin e ka në blegtori. Në këtë komunë ndodhet dhe një nga fermat më të mëdha në rang kombëtar, të mbarështrimit të gjedhit dhe të imtave.

Tabela 8 dhe 9 sigurojnë informacion të detajuar mbi numrin e bizneseve dhe sektorin ku ato operojnë.

*Tabela Nr. 8 Sipërmarrja dhe biznesi, 2014*

	Publik	Privat	Shuma	Biznese private	Biznes i madh	Biznes i mesëm	Biznes i vogël
<b>Gjepalaj</b>	0	41	41	41	6	7	28
<b>Maminas</b>	20	132	152	132	22	32	78
<b>Shijak</b>	73	500	573	500	83	124	293
<b>Xhafzotaj</b>	46	569	615	569	116	139	314

Burimi: Studimi, 2014

*Tabela Nr. 9 Bizneset private sipas sektorëve, 2014*


	Biznes i madh	Prodhim	Ndërtim	Biznes i mesëm dhe i vogël	Transport	Hoteleri Shërbime	Bujqësi Peshkim
<b>Gjepalaj</b>	6	4	2	35	4	25	6
<b>Maminas</b>	22	18	4	110	8	98	4
<b>Shijak</b>	83	63	20	417	66	345	6
<b>Xhafzotaj</b>	116	66	40	453	62	383	8

Burimi: Studimi, 2014


Sic dëshmojnë edhe tabelat 8 e 9, bizneset e vogla dhe të mesme përbëjnë rrëth 8 përqind të të gjithë bizneseve private në të katër njësitë e përgjedhura. Ndër bizneset e mëdha, mbizotërojnë ato prodhuese, kryesisht në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese te argjiles dhe gipsit. Shpërndarja e bizneseve private të mesme dhe të vogla ëshët thuajse e njëjtë në të katër njësitë e përgjedhura. Veprimtaritë ekonomike janë kryesisht të përqëndruara në sektorët e transportit, shërbimeve dhe bujqësisë, megjithëse sektori i shërbimeve zë një peshë specifike të konsiderueshme(rrëth 90 përqind) në krahasim me sektorët e tjera. Në figurën 4 paraqitet raporti i numrit të bizneseve publike e private në secilën njësi në krahasim me numrin mesatar të aktiviteteve në nivel rrëthi. Siç konstatohet edhe nga figura, në secilën nga njësitë e përgjedhura, numri total i aktiviteteve është shumë larg vlerës mesatare të të njëjitit tregues në nivel rrëthi.

Me qëllim që të krijohet një ide më e plotë mbi rëndësinë e veprimtarive ekonomike ekzistuese në rajonet e përzgjedhura, ndërtohet figura 5 e cila i krahason këto veprimitari ne popullsinë e secilës njësi si edhe me vlerën mesatare të të njëjtit tregues për trethin.

**Figura 4: Numri i bizneseve**



**Figura 5: Veprimitari ekonomike/popullsi**



#### ÷ Turizmi familjar dhe agroturizmi

Pas procesit të urbanizimit, më dinamik në territorin e komunës Xhafzotaj për shkak të afërsisë dhe qasjes së shpejtë në korridori Tiranë – Durrës qëndron një transformim i plotë strukturor i ekonomisë lokale, larg bujqësisë dhe industrisë, dhe i orientuar banorët dhe sipërmarrësit drejt sektorëve më tepër produktivë. Aktivitetet tregtare dhe shërbimet, të cilat në të gjithë vendet shfaqen dhe lulëzojnë si pasojë e grumbullimeve urbane, kanë qenë kontribuesit kryesorë të rritjes në zonë. Duke konsideruar pozitën gjeografike të zonës së Shijakut është mëse e qartë që turizmi është një komponent shumë i rëndësishëm i sektorit të shërbimeve, i cili po tregon shenja të mundësive në rritje për bregdetin, kulturën dhe eko-turizmin, duke filluar nga një stad mjaft fillestar. Me ritmin e lartë të ndërtimeve,

sidomos në zonat bregdetare, sektori i ndërtimit është bërë një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë në qarkun e Durrësit.

Sfidat e sektorit të turizmit do të jenë zhvillimi i shërbimeve me cilësi sa më të lartë, për të cilat kërkesa vendase do të rritet së bashku me të ardhurat, vazhdimi i diversifikimit në fushën e agroturizmit dhe rritja e mjafqueshme e cilësisë për të mundësuar konkurrencën në tregjet Evropiane. Përqëndrimi hapësinor i aktiviteteve ekonomike pasqyron dhe shpjegon shpërndarjen demografike.

- Faktorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik vendor të zonës së Shijakut;

Sa i takon potencialeve prodhuese, nga ecuria në vite rezulton se Shijaku është zona me potencialet më të vogla të prodhimit kjo dhe për vetë natyrën e zonës. Ajo është qendra e zonës dhe ka natyrën dhe zhvillimin tipik të një qyteti. Tre komunat e tjera, kanë potenciale prodhimi që plotësojnë nevojat e popullsisë së zonës madje dhe një pjesë të nevojave të tregjeve rajonale, Tiranë-Durrës. Mungesa e formalizimit të shkëmbimeve tregtare ndikon drejtpërdrejt në potencialin prodhues dhe orientimin drejt produkteve të duhuara.

Duke mos pasur të kontraktuar sasinë e produktit në avancë, planifikimi dhe motivimi për tu “rritur” i fermerëve është shumë i ulët. Nga tabela del qartë që potencialet prodhuese janë thuajse lineare gjatë gjithë periudhës për të cilën janë mbledhur të dhënat. Gjithashtu, vlen të përmendet që koeficienti i shfrytëzimit të tokës në dispozicion nuk është më i madh se 60%. Për cdo komunë ka rrëth 200 Ha tokë të lënë djerrë. Kjo ndikon drejtpërsëdrejti dhe në ecurinë dhe zhvillimin e industrisë agropërpunuese që operon në zonë. Ato përvec kapaciteteve të ulta përpunuese në shumë raste punojnë në mënyrë sezionale. Në përgjithësi kjo zonë ka përfituar shumë pak edhe nga subvencionet, shkak edhe politikat e qeverisjes në kuadër të alokimit të fondeve sipas rajoneve.

Në përgjithësi rajoni i Durrësit ku bën pjesë dhe zona e studimit, është renditur gjithmonë në rajonet që kanë përfituar me pak me një mesatere prej deri në 2012 prej 200,000 USD, ndërkohë që për vitin 2014 planifikimi për rajonin e Durrësit është afërsisht 8 mil lekë, apo 80,000 USD. Kjo një shifër e papërfillshme krahasuar me nevojat e sektorit. Vetëm Zona e studimit për 2014 numëron rrëth 5500 ferma, që janë potenciale për aplikim për të përfituar nga program i qeverisë për mbështetjen e fermerëve.

*Tabelë e potencialeve prodhuese gjatë 2009 – 2014*

Viti	Nr	Produkti	B.Shijak	Xhafzotaj	Maminas	Gjepalaj
2010	1	Fruta		100	750	20
	2	Perime		1800	3193	80
	3	Ullinj			617	15
	4	Vreshte			1411	201
	5	Agrume		200	238	

		Mish	100	196	
	6	Qumesht	30	200	2759
	7	Veze 000/kokrra		5600	1200
	8	Mjalte	1	5.8	
	9	Fruta	90	750	20
2011	1	Perime	1670	3109	80
	2	Ullinj	30	605	15
	3	Vreshte	150	1410	230
	4	Agrume	270	260	
	5	Mish	160	187	
	6	Qumesht	30	234	2800
	7	Veze 000/kokrra		5600	1732
	8	Mjalte	1	5.8	
	9	Fruta	120	780	30
2012	1	Perime	1700	3200	100
	2	Ullinj	30	620	15
	3	Vreshte	140	1390	230
	4	Agrume	240	250	
	5	Mish	180	190	
	6	Qumesht	30	234	2800
	7	Veze 000/kokrra		5500	1700
	8	Mjalte	1	5.8	
	9	Fruta	110	760	30
	1	Perime	1600	3200	100
	2	Ullinj	30	620	15
	3	Vreshte	140	1390	230
2013	4	Agrume	230	200	
	5	Mish	150	170	
	6	Qumesht	30	230	2600
	7	Veze 000/kokrra		5550	1650
	8	Mjalte	1	5.8	
	9	Fruta	100	750	20
	1	Perime	1800	3193	80
	2	Ullinj		617	15
	3	Vreshte		1411	201
2014	4	Agrume	200	238	
	5	Mish	100	196	
	6	Qumesht	30	200	2759
	7	Veze 000/kokrra		5600	1200
	8	Mjalte	1	5.8	

÷ Analizë e pikave të forta, të dobëta në zhvillimin ekonomik të zonës së Shijakut (SWOT)

1. Pikit e forta dhe mundësitë e zonës burojnë nga gjendja natyrale dhe historike, vendodhja gjeografike dhe një forcë punëtore relativisht e kualifikuar mirë.	1. Infrastruktura fizike e dobët është një shqetësim i madh për të gjithë aktorët vendorë sidomos për bizneset lokale. Furnizimi i pasigurtë me energji elektrike ishte shqetësimi kryesor, por sistemet e papërshtatshme të kanalizimeve dhe furnizimit me uje janë shumë të përhapura gjithashtu.
2. Agrobiznesi është një shtyllë themelore e ekonomisë lokale dhe diskutimet në fokus identifikan një potencial optimal në zgjerimin e volumit dhe marketingun e sektorit të agrobiznesit për të furnizuar tregun e brendshëm.	2. Konkurenca e biznesit informal paraqet një pengessë madhore për komunitetin e biznesit. Zhvillimi i sektorit privat frenohet akoma më shumë nga nivelet e larta të korruptionit dhe barra e burokracisë së institucioneve publike lokale.
3. Një tjetër pikë e fortë u identifikua në mjedisin e bukur natyror të vendit si dhe në trashëgiminë e pasur kulturore që janë burime të mëdha për zhvillimin e një turizmi ngazëllyes kur të krijohet infrastruktura e duhur dhe të zhvillohet promociioni i strukturuar i turizmit.	3. Kapaciteti i institucioneve bashkiake në përgjithësi u konstatua si i pamjaftueshëm, Komunikimi dhe bashkëpunimi mes qeverisjes vendore dhe biznesit mungon dhe kjo sjell faktin që bashkitë shumë shpesh shihen si pengesë sesa promotore të biznesit.

- Analizë e aktorëve vendorë - përcaktues të ecurisë së zhvillimit vendorë;

Nuk ka të dhëna të konsoliduara dhe të besueshme për aktivitetin e aktorëve të ndryshëm jo-qeveritarë në zonën e Shijakut. Megjithatë nisur nga praktikat e mira të identikuara në Shqipëri dhe në Evropë shoqatat e perdoruesve te ujit për shembull, provuan te ishin mekanizma te pershtashem per te menaxhuar infrastrukturen ujite se dhe shperndarjen e ujit ne nivelin lokal dhe permiresuan ne menyre te konsiderueshme aksesin ne dhe menaxhimin e burimeve ujore ne nivelet lokale. Bazuar ne keto suksese, duhet qe t'i kushtohet me shume vemendje ndertimit te kapaciteteve te strukturave qe koordinacione dhe lehtesojne funksionimin e kanaleve ndersa ruhet koncepti i menaxhimit te sistemit nga perdoruesit. Pervec kesaj, fermeret duhet te perfitojne me shume keshillim ne lidhje me perdorimin eficient te ujit per ujitje dhe menaxhimin e permiresuar te burimeve si dhe administrimin e qendrueshem. Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna dhe kontakte të shoqatave të ndryshme bujqësore në zonë.

Emërtimi	Rajoni	Komuna	OJF	SHBB	Funksioni	Nr.Antarëve		Emri Presidentit	Telefon	Aktiviteti i shoqates
						Gjithsejt	Femra			
<b>DURRËS</b>										
Shoqata Fruta Perime Xhafzotaj	Durrës	Xhafzotaj	OJF		po	11	0	Dashamir Hoxha	68237709	Prodhim shitje fruta perime
Shoqata "Vellezerit Vora"	Durrës	Xhafzotaj	OJF		po	8	0	Nexhmi Vora	693251339	Prodhim perpunim shitje verë
Shoqata e "Vresharet Koxhas"	Durrës	Xhafzotaj		SHBB	po	8	0	Xhelal Dervishi	682277370	Perpunim verë
Shoqata e Mekanizatoreve Rodon	Durrës	Ishëm	OJF		po	20	0	Agim Cani	692126349	Sherbime mekanike
Shoqata BIO-Ishmi	Durrës	Ishëm	OJF		po	7	1	Vlash Lazri	684010556	Asistence teknike
Shoqata "Demokracia"	Durrës	Rrashbull	OJF		po	35	25	Halit Shahini	682232753	Shitje prodhimi blerje inpute
Shoq. vreshtave dhe prodh. verës Rrashbull	Durres	Rrashbull	OJF		po	17	4	Kujtim Vidhi	682077982	Perpunim shitje vere
Shoqata e fërmereve "Erzen"	Durres	Katund I Ri	OJF		po	9	0	Flamur Balla	682979616	Ass.teknike
" SHBB Maminas"	Durres	Maminas		SHBB	po	8	1	Medi Koni	666067674	Fruta perime, Vresh
SHBB "OLIVOIL"	Durres	Rrashbull		SHBB	po	9	1	Kastriot Qerreti	685233043	Ulli dhe vaj ulliri
<b>10</b>			<b>7</b>	<b>3</b>		<b>132</b>	<b>32</b>			

- Politikat sektoriale kombëtare dhe përkthimi i tyre në nivel vendor kundrejt nevojave të zonës së Shijakut;

Zhvillimi ekonomik vendor eshte pergjegjesi e nje numri institucionesh qeveritare dhe jo-qeveritare. Procesi i zbatimit te programit të zonës funksionale per zhvillim ekonomik dhe social dhe programi i buxhetit afatmesem, perfaqesojne një platforme ne te cilen institucionet mund te kembejne mendime dhe bien dakort mbi hapat e metejshem per arritjen e synimit perbashket per zhvillim të qëndrueshmëm. Kjo platform duhet te perdoret me me shume vendosmeri dhe nuk duhet te mbetet ne nivelin e pergjithshem makro. Ajo duhet te permbaje detaje te mjaftueshme qe lejojne personat pergjegjes ne institacione te ndryshme per t'i perkthyer keto synime ne veprime konkrete.

Kjo gje behet edhe me e rendesishme ne nje mjedis te decentralizuar. Ne te njejten kohe, Qeveria do te duhet te percaktoje tregues me te mire monitorimi, qe lejojne analize te impakteve te veprimeve te ndryshme dhe te nxitet rishikimi i tyre aty ku eshte e nevojshme.

Sot roli primar i Ministrise se Bujqesise eshte te vendose dhe rregulloje nje kuader politikash dhe ligjesh qe mundeson bujqesine te operoje ne menyre eficente dhe te suksesshme si dhe te siguroje ofrimin e sherbimeve per fermeret e vegjel te sapo krijuar. Qe prej reformave, Ministria ka siguruar nje numer sherbimesh mbeshtetese si ato te ekstensionit, kerkimit shkencor, blegtorise dhe kontrollit te semundjeve te kafsheve dhe mbrojtjes se bimeve.

Keto reforma rezultuan ne nje numer te madh stafi te disponueshem ne nivel rrjeti. Megjithate, stafi qe punon per keto sherbime eshte i vogel ne numer dhe nje pjese te tij i mungon kualifikimi i nevojshem, e per pasoje cilesia le per te deshiruar. Sherbimet duhet te perkufizohen ne me shume

burime dhe te sigurohet me teper trajnim. Kerkesat per sherbimin publik kane ndryshuar, ndersa stafi shpesh mbetet po ai, i bllokuar diku midis strukturave te vjetra dhe atyre te reja me perjegjesi ende te pacaktuara qarte.

Do te ishte jashtezakonisht e rendesishme terheqja e fuqise punetore te kualifikuar drejt sherbimeve qeveritare si dhe peraktimi i fushave te perjegjesise sipas kerkesave ne ndryshim te nje sektori rural privat ne funksionim. Reformat dhe strategjite kombëtare jane nje fillim i mire per kete zhvillim; e megjithate eshte e nevojshme qe te behen perpjekje te metejshme per ta bere Ministrine me te orientuar drejt klienteve. Pa dyshim, nje hap i pare i rendesishem do te ishte kalimi drejt nje sherbimi civil qe i ben postet e tij te punes edhe ne nivel lokal me terheqese dhe te sigurta.

- Analizë e strukturës organizative aktuale dhe skema e sugjeruar për njësinë e reformuar të qeverisjes vendore

Bashkia Shijak ka një administratë prej 43 punonjësish. Struktura gjinore e stafit të Bashkisë është 50% femra dhe 50% meshkuj. Bashkia është e organizuar në tri Drejtori kryesore: zhvillimi ekonomik, shërbime mbështetëse, dhe planifikimi urban. Stafi i administratës së bashkisë në 80% të tij është me arsim të lartë (funksionet e drejtoreve, përgjegjësve si dhe të specialistëve) dhe 18% me arsim të mesëm (kryesisht punonjësit që ushtrojnë detyrat e mirëmbajtjes, shoferit, pastruesve). Bashkia e Shijakut, dhe Kryetari, nëpërmjet strukturave të varësinë është përgjegjës dhe për mbarëvajtjen e shërbimeve që ofrohen nga bashkia si ai i pastrimit, mirëmbajtjes së rrugëve, gjelbërimit, çerdheve etj. Në këto struktura janë të punësuar rreth 68 punonjës.

Këshilli i Bashkisë Shijak përbëhet nga 17 anëtarë, ky këshill mblidhet çdo muaj me mbledhje të hapura dhe të myllura sipas rendit të ditës i cili i bëhet i ditur çdo këshilltari pesë ditë para mbledhjes. Vendimet merren sipas rregullores së këshillit.

Administrata e Bashkisë, drejtohet nga Kryetari i Bashkisë, i ndihmuar nga N/Kryetari i saj. Administrata e Bashkisë është e organizuar në Drejtori, Sektorë, Zyra dhe ne qendra administrative. Poste të shërbimit civil sipas radhës hierarkike, janë; Drejtor Drejtoria/,Adminstrator, Përgjegjës Sektori/Zyre, Specialist. Drejtoritë janë njësi bazë të Strukturës Organizative të Bashkisë së Shijakut dhe përgjigen për një ose disa elementë të një fushe të caktuar. Sektorët përgjigen për aspekte të vecuara të këtyre elementëve dhe këta të fundit ndahen në zyra kur kjo është e mundur.

Struktura organizative, emërtimet dhe numri i personelit të tyre përcaktohen nga Kryetari i Bashkise dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Drejtorët e Drejtoreve kontrollojnë dhe janë përgjegjës për mbarëvajtjen e disa sektoreve sipas strukturës administrative të miratuar.

Bashkia e Shijakut garanton funksionin e saj nepermjet taskava te parashikuara ne ligj sipas akteve ligjore, ashtu edhe taksat e perkoheshme dhe tarifat , te miratuara nga Keshilli Bashkiak:

- a. Taksa mbi pasurine
- b. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

- c. Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja
- d. Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise mbi pasurite e paluajtshme
- e. Taksa per zenien e hapesirave publike
- f. Taksa e tableles
- g. Taksa e perkohshme e tregut
- h. Tarifa e gjelberimit
- i. Tarifa e pastrimit dhe e largimit te mbeturinave
- j. Tarifa e plazheve private
- k. Tarife per leje per perdomim strukture
- l. Tarifa e parkimit te automjeteve
- m. Tarifa e ndricimit
- n. Tarifat e sherbimit administrativ te Bashkise
- o. Tarifa per transportin publik
- p. Tarifa e autorizimeve per tregrim karburanti
- q. Tarifa e autorizimeve per qarkullimin ne qytet
- r. Tarifa per dhenien e lejeve ushtrim veprimtarie
- s. Tarifa e sherbimit veterinar
- t. Tarifa e urbanistikes
- u. Taksa te administruara nga agjentet tatimor

Marrëdhëniet me publikun: Kërkesat dhe ankesat me shkrim paraqiten në sektorin e Marredhenieve me Publikun. Afati për dhënien e përgjigjes kërkesave apo ankesave të qytetarëve është 40 dite nga dita e paraqitjes së saj sipas ligjit, por ne praktikat e përditshme është i përshtapte. Pritja e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve bëhet nga nëpunësit e Sektorit, të cilët pasi dëgjojnë qytetarët, plotësojnë bashkarisht formularin përkatës dhe e përcjellin këtë kërkesë/ankesë drejtore përkatëse, në varësi të specifikave të kërkesës apo ankesës. Vizitorët do të lejohen të hyjnë nëpër zyra, vetëm pasi nëpunësi i zyrës së pristes të ketë komunikuar dhe të ketë marrë miratim nga nëpunësi që pret vizitën. Në çdo rast, vizitori paiset me një flete-hyrje, ku shënohen zyra që e pret dhe kohëzgjatja e vizitës.

Orari i punës është 8.00 – 16.00 cdo ditë nga e Hëna në të Premte.

**Përballja me vështirësitet qeverisëse në nivel vendor pas krijimit të bashkive të të reja në Shqipëri do të kërkojë një qasje holistique për të përforcuar kapacitetin e institucioneve të qeverisë dhe shoqërisë civile.** Shumë prej pengesave qeverisëse të pushtetit vendor janë të përhapura gjërisisht, shpeshherë me përgjegjësi të shpërndara midis disa institucioneve shtetërore dhe si pasojë kërkojnë një qasje sistematike për të forcuar kapacitetet në të gjithë nivelin qeverisës. Sfidat komplekse qeverisëse, si ulja e rasteve të korruptionit në të gjithë sektorin publik dhe forcimi i sundimit të ligjit, kërkojnë një strategji afat mesme/gjatë të mbështetur nga bashkëpunimi i

qëndrueshëm dhe mekanizmat monitorues. Adresimi i këtyre sfidave do të kërkojë përpjekje të qëndrueshme, koordinim të fuqishëm politik, ndërtimin e zgjeruar të kapaciteteve në institucionet shtetërore, dhe angazhim kuptimplotë me shoqërinë civile. Bashkia mund të arrijë rezultate të prekshëm në këto fusha duke përcaktuar prioritete, veprime të nevojshme, dhe përgjegjësi institucionale, dhe duke shpërndarë burimet e nevojshme, e përfshirë edhe fondet e asistencës së huaj. Kriteret dhe kërkesat për procesin e negocimit të antarësimit në BE ofrojnë një udhëzim të dobishëm për veprimtarinë, edhe pse Qeveria në nivel kombëtar mund gjithashtu të konsideroj adresimin e sfidave të tjera problematike të qeverisjes vendore, të cilat shkojnë përtej *acquis* të BE, veçanërisht atyre që prekin shpërndarjen e shërbimeve publike dhe klimën e biznesit (duke përfshirë fokusimin tek përfitimet sociale, rritjen e transparencës në financimet e shëndetësisë, dhe uljen e pagesave informale).

Për të lëvizur përtej kërkesave dhe ndryshimeve ligjore, qeverisë në nivel i duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme dhe synimet e ndërmjetme me referencë ndaj *indikatorëve* të matshëm dhe të sigurojë monitorim të rregullt të progresit në zbatim. Ky kuadër rezultatesh do të ishte ideal nëse përfshihej në procesin e hartimit, zbatimit monitorimit dhe vlerësimit të planeve të zhvillimit territorial vendor. Sistemi i Integruar i Planifikimit ka lidhur, në një masë të konsiderueshme, priorititet politike me përgatitjet e buxhetit edhe në nivel vendor dhe shënon një arritje të rëndësishme në këtë drejtim. Gjithsesi, koordinimi i politikave dhe kapaciteti monitorues në qeverinë qendrore duhet të forcohet më tej, veçanërisht për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe konsekuent të reformave që kërkijnë veprime konkrete nga njësítë e qeverisjes vendore. Ndarja e qartë e përgjegjësive për rezultatet kryesore të qarta për secilin prej niveleve të institucioneve do të ndihmonte në përmirësimin e koordinimit midis agjencive të shumta të përfshira në aspekte të ndryshme të një reforme të caktuar. Përmirësimi i monitorimit të statusit të zbatimit të ligjeve dhe politikave të reja do të ndihmojë që këto masa politike të arrijnë rezultate konkrete dhe jo të mbeten thjeshtë “në letër”. Institucionalizimi i monitorimit sistematik për përputhjen e veprimeve të administratës publike me vendimet e gjykatave do të ndihmonte në adresimin e problemeve kryesore në sundimin e ligjit.

**Zbatimi jokonsekuent i ligjeve dhe rregullave mund të adresohet përmes përmirësimit të kapaciteteve planifikuese të ligjeve në qeveri dhe përmes konsultimeve më sistematike me palët e interesuara.** Në nivel vendor qeveria mund të reduktojë mangësitë në implementim duke pritur deri për dorëzimin e projektligjeve të reja për miratim nga parlamenti, dhe marrjes së masave të nevojshme buxhetore dhe përgatitjes së legjisacionit dytësor që qartëson planin e implementimit. Gjithashtu shumë problemet të implementimit mund të anashkalohen përmes përdorimit më të gjerë të konsultave të avancuara me grupet e interesit (si për shembull shoqatat e biznesit) ndërkohë që përgatiten ligje dhe rregulla të reja që prekin aktivitetin e tyre. Konsultimi i rregullt me shoqërinë civile mund gjithashtu të ndihmojë në monitorimin e implementimit të ligjeve e rregullave dhe

kryerjen në kohë të përshtatjeve për të reduktuar rrezikun nga pasojat e paqëllimta që mund të sjellin instrumentet e reja ligjore.

**Thjeshtëzimi i procedurave, duke vendosur standarde të qarta shërbimi, dhe sensibilizimi i publikut kanë gjithashtu potencialin për të përmirësuar shpërndarjen e shërbimeve publike, për të ulur pagesat informale, dhe për të forcuar besimin e publikut.** Evidenca nga studime të kohëve të fundit nuk konfirmojnë përfundimisht tendencën rritjeje të kënaqësisë së bizneseve dhe publikut të gjerë me shërbimet e dhëna nga institucionet publike. Përmirësimi të mëtejshme mund të arrihen permbashkët me reformave politike që sigurojnë qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve kyç si mbetjet urbane, ujësjellësi dhe transporti, e kombinuar kjo me masa për të forcuar përgjegjshmërinë përfundimtare. Zhvillimi i procedurave të qarta dhe standardeve të shërbimit përfundimtare kyç rregullatore dhe shërbimet publike, në përpjekje me dedikuara përfundimtare rritur sensibilizimin e publikut, duhet të forcojë kërkesën midis bizneseve dhe firmave, dhe mundësojë përmirësimin e performancës. Përkushtimi i rregullt ndaj indikatorëve kyç të rezultateve të bashkive, dhe ofruesve të shërbimeve do të kërkojë përpjekje dhe burime domethënëse, por me shumë gjasa do japë frute në rritjen e përgjegjshmërisë, performancës dhe besueshmërisë së publikut.

Krahës politikës fiskale, cilësia e qeverisjes dhe institucioneve ndikon dukshëm mbi rritjen ekonomike. Mënyra e qeverisjes me efikasitet dhe funksionimi i institucioneve publike kanë një ndikim të drejtpërdrejt në vendimet e bizneseve dhe përfundimtare rritjen e zhvillimin e sektorit privat. Niveli i qeverisjes mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik nëpërmjet nxitjes ose jo të investimeve private, duke ndikuar indirekt në nivelin e rritjes ekonomike. Ndikimi i qeverisjes në nxitjen e firmave përfundimtare eshtë parë në dy këndvshtrime, në nivel makro dhe në nivel mikro. Niveli makro i qeverisjes lidhet me ndikimin që kanë institucionet dhe politikat qeveritare, duke iu referuar konkretisht sistemit gjyqor, hartimit dhe miratimit të kuadrit ligjor, korruptionit, qëndrueshmërisë së politikave, etj. Kurse niveli mikro paraqet një lidhje më direkte midis biznesit dhe shtetit. Disa nga treguesit kryesorë që matin ndikimin e shtetit në vendimarrjen e firmave janë: cilësia e rregullave dhe informacioni që firmat zoterojnë në lidhje me to, koha që shpenzojnë privatët në zyrat e punonjësve publikë, numri i procedurave përfundimtare hapjen e bizneseve të reja, dhënia e rryshfeteve zyrtarëve publikë, lobimi, etj.

Cilësia e qeverisjes dhe e institucioneve të sektorit publik ndikon dukshëm në zhvillimin ekonomik dhe shërben përfundimtare shpërndarjen e diferencave në rritjen ekonomike midis shteteve. Kjo eshtë provuar edhe nga shumë studime të ndryshme empirike. Në këtë kontekst institucionet ndikojnë në ecurinë e sektorit privat në dy dimensione: në planin makroekonomik duke prekur kryesisht aspektin ligjor, rregullator dhe kufizues ndaj bizneseve dhe në planin mikroekonomik i cili pasqyron lidhjet më të ngushta midis këtyre subjekteve që kanë të bëjnë me marrjen e licencave, pagesën e tatimeve, etj. Një nga elementet e përbashkët të dy dimensioneve, i cili pengon dukshëm ecurinë e bizneseve dhe krijon

pasiguri në vendimarrje është korruksiioni. Ai shfaqet që nga format më direkte si rryshfetet e deri tek tendencat për të ndryshuar ligjet dhe rregullat për interesa private.

Qeverisja merr një rëndësi të veçantë sidomos në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion, pasi promovimi i një qeverisje të mirë kërkon ndryshime thelbësore në mënyrën sesi janë ndërtuar marrdhënet brenda sistemit politik dhe atij ekonomik. Sistemet politike të krijuara gjatë kalimit të vendeve nga sistemi komunist në ekonomitë në tranzicion, luajtën një rol të rëndësishëm në implementimin e reformave ekonomike për të përshtypet e procesin e tranzacionit. Shëmbulli më i qartë janë vendet e Europës Qëndrore dhe Republikat Balltike, të cilat e kaluan me sukses këtë fazë, falë një sistemi politik dhe një qeverisje të mirë. Kurse Shqipëria nuk ka bërë mjaftueshëm në këtë drejtim. Vlerat e treguesve të qeverisjes vazhdojnë të ndikojnë negativisht, ose shumë pak pozitivisht në cilësinë e qeverisjes edhe pse kanë kaluar pothuajse 20 vjet nga fillimi i tranzacionit. Ekuilibri politik vazhdon të jetë i brishtë dhe kjo ka ndikuar dukshëm në zbatimin e reformave ekonomike dhe në vazhdimsinë e tyre. Edhe pse është vlerësuar pozitivisht në cilësinë e ligjeve dhe rregullave, respektimi dhe zbatimi i tyre është mjaft problematik. Gjithashtu niveli joefiqënt i shërbimeve publike, kontrolli i ulët ndaj korrupsionit, destabilizimet e shpeshta politike kanë bërë që Shqipëria të klasifikohet në vendet e fundit në rajon dhe të jetë shumë larg mesatares së Europës Qëndrore dhe Bashkimit European.

**Faktorët që ndikojnë në eficiencën e sektorit publik:** Matja e eficiencës përgjithësisht nënkuption vlerësimin e kostove dhe të outputit të realizuar dhe krahasimin ndërmjet tyre. Mund të themi se aktiviteti i sektorit publik është eficent në qoftë se nëpërmjet përcaktimit të shumës që duhet shpenzuar, të sigurohet përfitimi më i madh i mundshëm për popullësinë e një vendi. Disa nga faktorët që ndikojnë në eficiencën e sektorit publik janë: praktikat buxhetore, manxhimi i burimeve njerzore, praktikat ‘e-government’, decentralizimi fiskal, privatizimi, përpjekjet për vlerësimin e performancës, konkurenca dhe koordinimi brenda qeverisë. Nga kërkimet empirike është siguruar informacioni i nevojshëm në lidhje me efektin që ka mbi eficiencën, përdormi ose kombinimi i ndryshëm i inputeve. Rezultate të rëndësishme janë gjetur në tre fusha: Së pari rritja në eficiencë mund të sigurohet nëpërmjet rritjes së numrit të operacioneve, bazuar në të dhënrat e marra kryesisht në sektorin e arsimit dhe shëndetsisë. Kurse efekti në shërbimet e tjera publike si barazia në aksesin ndaj shërbimeve, cilësia dhe efektiviteti i shërbimeve, duhet të merret parasysh kur përdoren këto metoda përmirësimin e eficiencës. Së dyti decentralizimi funksional dhe politik i qeverisjes është mjaft i rëndësishëm për rritjen e eficiencës dhe së treti manaxhimi i burimeve njerzore ka gjithashtu vlerë të konsiderueshme. Një aspekt i efektit të manaxhimit të burimeve njerzore është satisfaksi i kënaqsjës së punonjësve dhe motivimi në punë. Gjithashtu pagat, vlerësimi në punë, autonomia, etj janë të tjera aspekte.

Faktorët që ndikojnë eficiencën e sektorit publik mund të ndahen në tre kategori: faktorë ekonomikë, institucionalë dhe demografikë. **Faktorët ekonomikë** më kryesorë të klasifikuar sipas teorisë dhe

studimeve empirike janë të ardhurat për frysë, inflacioni dhe indeksi i hapjes së tregtisë. Të ardhurat për frysë ndikojnë në dy mënyra. Ato mund të rritin kostot e shërbimeve publike, por edhe mund të ndikojnë pozitivsht në outputin e realizuar nga sektori publik. Megjithatë në bazë të studimeve empirike (La Porta et al. 1999) në vendet e varfëra dhe në zhvillim vihet re një lidhje pozitive e këtyre dy variablate, pra të ardhura të ulta për frysë dhe performancë dhe eficencë e dobët e qeverisë. Inflacioni është një variabël i cili ndikon negativisht, pasi komplikon vendimarjen ekonomike. Kurse indeksi i hapjes tregtare ndikon pozitivsht nëpërmjet rritjes së konkurrencës në vend, duke përfshirë edhe sektorin publik, ndonëse nuk është i lidhur drejtpërdrejt. Gjithashtu sa më i lartë ky indeks aq më i hapur është një shtet ndaj inovacionit dhe progresit teknologjik. **Faktorët institucionalë**, siç u përmend edhe mësipër janë kontribues të rëndësishëm në performancën dhe eficencën e sektorit publik. Sipas Putnam (1993) dhe Gellner (1994) shkalla e zhvillimit të shoqërisë civile influencon eficencën: bashkëpunimi midis qytetarëve dhe funksionimi i institucioneve jo-shtetrore u lejon atyre të kenë më shumë kontroll efektiv mbi politikanët dhe punonjësit e administratës. Kontrolli i korruptionit është një ndër faktorët institucionalë i cili konsiderohet edhe si intuitiv. Variabla të tjera janë: shkalla e demokracisë, praktikat buxhetore, kontabiliteti dhe raportimi, vitet e qëndrimit në qeveri të një force politike, infrastruktura sociale, etj. **Faktorët demografikë**. Shpërndarja e moshës së popullsisë është një faktor i cili prek kryesisht sektorin e arsimit dhe të shëndetsisë. Popullsia me moshë të re rrit kostot në sektorin e arsimit në krahasim me outputin e prodhuar në këtë sektor. Kurse një popullsi me moshë të vjetër ka të njëtin efekt, por në sektorin e shëndetsisë. Dëndësia e popullsisë ndikon pozitivisht në eficencë, duke ulur kostot e ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet ekonomive të shkallës si edhe duke ulur kostot e transaksionit. Sipas studimeve të ndryshme edhe faktorët klimaterikë ndikojnë në eficencë.

### Vështirësitet në vlerësimin e eficencës

Matja e eficencës kërkon njohjen e informacionit sasior dhe cilësor në lidhje me kostot dhe outputin e shërbimeve dhe të mirave publike.

### Aspekte metodologjike

Teknikat që po përdoren më gjërësisht në vitet e fundit janë medoda jo-parametrike (DEA) dhe metoda parametrike (analiza e kufirit stokastik). Megjithatë këto dy metoda konsiderohen ende në fazën e zhvillimit të tyre. Një nga disavantazhet e të dyja metodave është se vlerësimi i eficencës varet shumë nga gjykimet teknike, të cilat në natyrën e tyre janë më shumë politike, sesa thjesht teknike. Prandaj kur studiojmë eficencën do të ishte e rëndësishme përfshirja e politikbërësve në procesin e ndërtimit të modelit. Një nga avantazhet e metodës së kufirit stokastik ndaj analizës DEA është se jo vetëm vlerëson ineficencën, por nxjerr në pah edhe shkaktarët e mundshëm të saj. Megjithatë metodat joparametrike përdoren gjërësisht në analizën e eficencës së sektorit publik për shkak të thjeshtësisë dhe aplikimit në numër të vogël vrojtimesh. Gjithashtu këto metoda ndeshen edhe në analiza krahasuese të eficencës midis shteteve të ndryshme.

## Përcaktimi i objektivave

Problemi i eficencës është shumëplanësh. Objektivat në të cilat është drejtar qeveria kanë ndikim në eficencë dhe përcaktimi i tyre është i rëndësishëm. Mund të ndodhë që një qeveri është e orientuar ndaj mbrojtjes kombëtare. Kanalizimi i shumë shpenzimeve në këtë drejtim edhe mund të jenë eficente, lë shumë pak hapsira për shpenzime në fusha të tjera si arsim, shëndetësi, politika sociale, etj. Nga ana tjetër duhet dalluar rasti i kundërt kur qeveritë janë të orientuara drejt politikave të duhura, por kanë një përdorim joeficent të shpenzimeve. Të dy rastet e përmëndura shkaktojnë ineficencë në alokimin e burimeve. Cilët janë faktorët që mund të shkaktojnë ineficencë kur objektivat e qeverisë janë ato të duhurat? Së pari një problem i cili është mjaft i pranishëm ka të bëjë me zhvendosjen e shpenzimeve nga ato zona apo aktivitete që kanë më shumë nevojë, duke u bazuar në kriterin e drejtësisë në shpërndarje për të patur një zhvillim të qëndrueshëm, psh. shpenzimet për shëndetësinë mund të zhvendosen nga zonat rurale në zonat urbane, nga sëmundjet që prekin shtresat e varfëra në ato që prekin të moshuarit, apo të pasurit, ose zhvendosja e shpenzimeve për arsimin primar në atë sekondar apo terciar.

Një tjetër problem të cilit nuk i kushtohet shumë vëmendje është edhe mënyra e matjes së produktit të realizuar nga një aktivitet shtetëror. Po marrim rastin e arsimit dhe të shëndetësisë, të cilat janë aktivitete që kërkojnë në mënyrë më intensive përdorimin e faktorit punë. Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve buxhetore për këto kategori shkon për paga dhe shpenzime administrative të personave që e sigurojnë këtë shërbim si mësuesit, mjekët, etj. Në këmbim të kësaj ata duhet të realizojnë një produkt i cili t'u sjellë përfitime nxënësve, apo pacientëve. Në qoftë se këto shpenzime të kryera, nuk shoqërohen më një produktivitet të lartë nga ofruesit e tyre atëherë themi se shpenzimet qeveritare të kryera në këtë drejtim janë joproductive, ose ineficente dhe u sigurojnë një përfitim më të ulët personave në nevojë. Pra kjo çështje lidhet me produktivitetin, ose normën e kthimit të këtyre shpenzimeve. Së treti korrupzioni nëpërmjet formave të ndryshme të tij ka treguar që ndikon negativisht mbi eficencën dhe produktivitetin. Ai paraqitet në sektorin publik në formën e punonjësve fantazmë, të cilët marrin një pagë por nuk bëjnë asgjë, ose të dypunësimit i cili i bën individët të investojnë më pak energji dhe t'i kushtojnë më pak rëndësi punës në sektorin publik, mosparaqitjet në punë për arsyë të ndryshme, rritja e stafit në mënyrë artificiale, nepotizmi, etj. Krahës faktorëve të përmëndur mësipër egzistojnë edhe faktorë të tjerë që lidhen me kulturën e vëndeve të ndryshme, si sjellja ndaj punës, apo intensiteti i të punuarit, faktorë klimaterike që lidhen me ndikimin e kushteve atmosferike, psh pasditet e nxehta, ose i ftohti i madh, ose faktorë që lidhen me traditat fetare, psh pushimet gjatë festave, etj. Këto faktorë janë të pranishëm dhe luajnë një rol të rëndësishëm, por përcaktimi dhe matja e tyre është mjaft e vështirë. Një tjetër faktor që ndikon eficencën e përdorimit të shpenzimeve është adresimi i tyre në investime të cilët nuk kanë një kthim shumë të lartë. Ky fenomen quhet zhvendosja e shpenzimeve. P.sh meqënëse jemi tek sektori i arsimit, niveli i analfabetizmit është një tregues i ecurisë së këtij sektori. Ky tregues është më i lartë në zonat malore, zonat periferike të qyteteve, si edhe ne zonat rurale. Në këtë kontekst në thelb të shumë programeve

qeveritare ka qënë orientimi i shpenzimeve në zhvillim të zonave rurale, ose të zonave jo shumë të zhvilluara për të siguruar një përafrim të zhvillimit ekonomik në të gjitha zonat. Por jo gjithmonë këto fonde kanë shkuar në këtë drejtim duke pësuar një zhvendosje drejt zonave urbane duke bërë që këto investime të mos kenë përfitimin më të lartë të mundshëm, që është kushti primar i eficiencës (Banka Botërore, 2006).

### Vlerësimi i performancës dhe eficiencës nëpërmjet indekseve

Vlerësimi i performancës dhe eficiencës së sektorit publik është i rëndësishëm nqs duam të nxjerrim një lidhje midis madhësisë së shpenzimeve publike dhe përfitimeve që marrin qytetarët prej tyre.

**Indeksi i Performancës së Sektorit Publik (PSP):** Performanca e sektorit publik është përcaktuar si outputi i realizuar nga aktivitetet publike. Ajo është një instrument i rëndësishëm nëpërmjet të cilit mund të bëhen përmirësime në manaxhimin e sektorit publik. Siç e komentuan edhe mësipër madhësia e sektorit publik është e lidhur ngushtë me performancën dhe eficiencën e sektorit publik. Në këtë kontekst natyrshëm lind pyetja: Sa ndikon madhësia e sektorit publik në performancën e tij? Nga pikpamja teorike në shtetet demokratike madhësia dhe struktura e sektorit publik nuk është endogjene por reflekton preferencat e votuesve, të cilët vendosin për shkallën e ndërhyrjes dhe priorititet që duhet të ketë qeveria. Por në praktikë nuk ndodh kështu për disa arsy: Së pari preferencat e votuesve mund të shtrembohen nga mungesa e informacionit në lidhje me madhësinë e sektorit publik dhe me lidhjen e inverse që ka me sektorin privat. Së dyti është shpeshherë e mundshme që të ndryshohet outputi i sektorit publik pa ndryshuar madhësinë e tij, ose të prodhohet i njëjtë output me një madhësi më të vogël, duke ndryshuar strukturën. Së terti preferencat e shoqërisë në lidhje me aktivitetet publike janë në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe demografike. P.sh gjatë periudhave të reçensionit qytetarët interesohen më shume për pagesat e papunësisë dhe sigurimeve shoqërore sesa në periudhat e rritjes. Së katërti preferencat e qytetarëve mund të mos merren parasysh nga politikanët dhe punonjësit e administratës. Për ti dhënë një përgjigje edhe më konkrete pyetjes së mësipërme do të analizojmë përfundimet në lidhje me vlerësimin e performancës (Afonso, Schuknecht, Tanzi 2006) dhe krahasimin e tyre në shtete të ndryshme. Indeksi i performancës sipas Afonso et.al 2006 analizon efektin e shpenzimeve publike në mirqënien e qytetarëve duke u bazuar në disa tregues ekonomikë dhe socialë të cilët klasifikohen si: treguesit e mundësisë dhe treguesit Musgrave.

### Treguesit e mundësisë

**1. Administrata** – është një nga treguesit, në të cilin përfshihen elemente si korrupzioni, cilësia e sistemit gjyqshor, ekonomia informale. Këto elemente ndikojnë në securinë e performancës së sektorit publik nga pikpamja e sigurimit të të drejtave të pronësisë, zbatimit të ligjit dhe krijimin e një ambienti rregullator të përshtashëm për zhvillimin e vendit.

**2. Arsimi** – është një nga elementet kryesore të rritjes ekonomike të një vendi. Prandaj dhe cilësia e tij tregon nëse shpenzimet qeveritare të bëra në këtë sektor kanë ndikuar vërtet në përmirësimin e tij. Cilësia e arsimit është e matur nëpërmjet dy treguesve që janë: numri i nxënësve të rregjistruar në

arsimin sekondar i cili vlerëson minimumn e njohurive që duhet të ketë një nxënës që të ketë mundësi të njëjtë në të gjitha vendet e industrializuara, si edhe rezultatet në lëndën e letërsisë, matematikës dhe në lëndët e tjera shkencore.

**3. Shëndetsia** – edhe shpenzimet qeveritare në drejtim të sektorit të shëndetsisë janë të rëndësishme. Si matës të cilësisë së shpenzimeve në shëndetsi janë përdorur vdekshmëria foshnjore dhe jetëgjatësia mesatare. Këta tregues reflektojnë më së miri cilësinë e shërbimit shëndetsor dhe aksesin e barabartë që duhet të ketë popullsia e një vendi ndaj këtij shërbimi. Shërbimi shëndetsor bazë shikohet si një kusht i domosdoshëm për të patur mundësi të barabarta në ekonominë e tregut.


### Treguesit standartë të Musgrave

Ndërsa treguesit e mësipërm kishin më tepër karakter mikroekonomik, të fokusuar në sektorë të veçantë, treguesit e Musgrave kanë më tepër karakter makroekonomik. Ata janë të fokusuar në efektin që kanë shpenzimet qeveritare në të gjithë ekonominë dhe më konkretisht janë:

**1. Shpërndarja e të ardhurave** – për të vlerësuar këtë element është përdorur koeficënti GINI, i cili mat nivelin e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave në një vend, duke dhënë informacion edhe për nivelin e varfëris. Përmirësimi i këtij treguesi, do të thotë sa më shumë të ardhura t'i takojnë 40 përqind të popullsisë që është më e varfra, aq më e mirë do të ishte performanca e qeverisë mbi këtë indikator.

**2. Stabiliteti ekonomik** – është një tjetër tregues i rëndësishëm në zhvillimin e një vendi. Norma mesatare e inflacionit për një periudhë 10 vjeçare si edhe qëndrueshmëria e rritjes ekonomike janë përdorur për të vlerësuar efektin e shpenzimeve në drejtim të stabilitetit ekonomik.

**3. Performanca ekonomike** – është gjithashtu e lidhur me treguesin e mësipërm. Nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet nëse qeveria po bën një shpërndarje të burimeve e cila maksimizon mirqënen e qytetarëve. Ky tregues përbëhet nga tre variabla: produkti i brendshëm bruto për frymë, norma e rritjes së PBB real për një periudhë 10 vjeçare si edhe norma e papunësisë.



- Rekomandime për masa afatmesme;
  - ÷ Modernizimi i sherbimeve mbeshtetese dhe trajnimi per stafin e nivelit lokal dhe sherbime me te orientuara nga klienti, nepermjet ristrukturimit te bazes nxiteze (me bazekomuniteti);
  - ÷ Thithja e stafit te kualifikuar brenda sherbimit civil, duke rritur sigurine e vendit te punes dhe duke aplikuar paketa terheqese pagash;
  - ÷ Percaktimi i pergjegjesive te pushtetit lokal ne procesin e konsolidimit të njësive të reja të pushtetit vendor;
  - ÷ Perfundimi i pergamantjes se akteve nenligjore, te cilat percaktojne qarte pergjegjesite e niveleve te ndryshme te qeverisjes, kompetencat e tyre vendim-marrese dhe transferimin e fondeve; dhe
  - ÷ Perpunimi i profileve per punesim dhe nevojat per trajnim te bazuar ne kete identifikim.

▪ **Shërbimet publike në Shijak si vlerësim i parimeve të qeverisjes dhe autonomisë së saj:**

- Shërbime për publikun të nevojshme në zonën e Shijakut në përgjigje e synimit strategjik për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar;

Në këtë seksion të raportit do të analizohen tre shërbime thelbësore: transporti brenda dhe jashtë zonës, furinizimi me ujë të pijshëm, si edhe mbledhja, grumbullimi dhe përpunimi i mbetjeve. Përpara se të analizohen secili nga shërbimet për publikun të përmendura më lart, le të sqarojmë se cili është ndryshimi ndërmjet këtyre shërbimeve dhe shërbime publike. Përdorimi i këtyre termave nuk është i rastësishëm: Sipas literaturës, shërbimet publike përfaqësojnë shërbimet e siguruara nga qeveria për qytetarët e saj, ose drejtëpersëdrejti (nëpërmjet sektorit publik të prodhimit të të mirave publike) ose jo drejtëpersëdrejti(duke financuar sigurimin privat të shërbimeve), zakonisht të shoqëruara nga konsensusi social mbi atë që një numër shërbimesh do t'ju sigurohen domosdoshmërisht të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga të ardhurat ( Chavez.D, 2006). Në këtë kuptim, shërbimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen shërbime publike, por mund të kategorizohen si shërbime të dobishmërisë publike.

## Kutiza 2: Bashkia Shijak

Studimi tregoi se në NJQV Shijak nuk është organizuar asnjë mbledhje e jashtëzakonshme e Këshillit në 2 vitet e fundit. Vendimet e Këshillit dokumentohen me shkrim dhe ato bëhen publike. NJQV Shijak ka një plan buxhetor afatmesëm për këtë vit dhe 2 vitet në vazhdim I cili është miratuar në Këshill dhe është bërë gjithashtu publik. Nga të dhënat e dokumentit të buxhetit tregohet se buxheti për këtë vit nuk është përgatitur dhe nuk është miratuar në Këshill. Studimi tregoi se buxheti është bërë publik dhe se janë audituar bilancet e NJQV-së për vitin e kaluar dhe se ky I fundit është aprovuar në mbledhjen e Këshillit. Nga protokollet e mbledhjeve të grupit për strategjinë buxhetin dhe integrimin verifikohet se ky grup është I ngritur dhe funksional. Studimi tregon se ekziston një Plan Strategjik i Zhvillimit i përgatitur në NJQV gjatë 5 viteve të fundit cili është miratuar në Këshill dhe është bërë publik pa ju bërë rregullim.

**Në studim vihet re se nuk ka një plan strategjik për menaxhimin e mbetjeve hartuar këto 5 vitet e fundit dhe strategjia e menaxhimit të mbetjeve nuk është miratuar në Këshillin e NJQV-së dhe as nuk është bërë publike apo rifreskime.**

## ÷ Mbetjet urbane

Për të vlerësuar procesin aktual të manaxhimit të mbetjeve ne zonën e Shijakut në çdo njësi të qeverisjes vendore, grupi kërkimor ndërmori një analizë të detajuar me metodën SWOT. Ky vlerësim konsistoi në identifikimin e avantazheve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve që i gjithë sistemi apo elementët përbërës të tij shfaqin. Për të realizuar këtë analizë janë përdorur të gjitha të dhënat e mbledhura nga takimet me si dhe duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje të drejtpërdrejtë apo indirektëmen menaxhimin e mbetjeve, në drejtim të aspekteve ligjore dhe administrative, cilësorë dhe efektivë, ekonomik dhe mjedisor. Rezultatet e kësaj analize janë përbledhur në tabelën e mëposhtme:

<i>Pikat e forta</i>	<i>Pikat e dobëta</i>
<p>Në planin lokal të zhvillimit çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve janë priorizuar si në nivel rajonal ashtu edhe vendor;</p> <p>Autoritetet vendore në cdo njësi në zonë janë të ndërgjegjësuar që përmirësimi i manaxhimit të</p>	<p>Në të gjitha NJQVtë e zonës mungojnë instrumentat ligjore vendore (p.sh., planet lokale të menaxhimit të mbetjeve, rregulloret e brendshme për administrimin e mbetjeve, protokollet, standartet, detyrimet përofruesit e shërbimit, qytetarët, bizneset etj);</p> <p>Mosofrimi i shërbimit nga komuna, sjell paqartësi ndaj detyrimeve dhe obligimeve të bashkive dhe</p>

<p>mbetjeve dhe më konkretisht shërbimet e pastrimit janë faktorë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, zhvillimin e turizmit, etj.</p>	<p>kununave, si dhe përbën një burim ndotjeje dhe kosto shtesë për shërbimin e pastrimit të Bashkivsë, e cila e ofron këtë shërbim;</p>
<p>Njësitë vendore janë angazhuar në ndjekjen e një politikë mbështetëse kundrejt përmirësimit të buxhetit lokal për menaxhimin e mbetjeve, si në drejtim të rritjes së shpenzimeve për më shumë shërbime ashtu dhe për më shumë investime (vendosja e koshave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve);</p>	<p>Në njësitë vendore ka kapacitet njerëzore të limituara, të pa-trajnuara për ofrimin e një shërbimi sipas standardeve, mangësi teknike dhe administrative në stafin vendor të menaxhimit të mbetjeve, si dhe mungojnë strukturat bashkiakë direkt përgjegjëse për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes urbane nga mbetjet;</p>
<p>Në zonën e Shijakut është rritur kërkesa nga bizneset dhe ekonomia vendore si dhe komuniteti për të kontribuar më shumë drejt përmirësimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;</p>	<p>Mundësitet financiare lokale (buxheti i miratuar dhe niveli aktual i mbledhjes së tarifave) nuk janë të mjaftueshme për të përbushur nevojat për investime (si ndërtimin e një lendfilli të ri të propozuar), përparesitë dhe objektivat e bashkive; Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve, në sajë të infrastrukturës të dëmtuar (pika të hapura apo të pastandardizuara të grumbullimit të mbetjeve voluminoze), dhe mbulimi i pamjaftueshëm, nuk është as efikas dhe as efektiv;</p>
<p>Bashkia Shijak në bashkëpunim me komunat përreth ka një potencial drejt aplikimit të skemave për manxhimin e integruar të mbetjeve, falë pranisë së bisneseve private që merren me trajtimin e mbetjeve që mund të riciklohen, vajrat lubrifikant të përdorur dhe mbetje të tjera nga metalet.</p>	<p>Fushat depozitimit të mbetjeve në të gjitha bashkitë e qarkut nuk administrojnë mbetjet, janë jashtë çdo standardi teknik apo mjedisor, nuk kanë portë hyrese dhe siguri; mungojnë stafet dhe mjetet teknike; nuk kryhet monitorimi i mbetjeve; ka prezencë të të gjitha llojeve të mbetjeve përfshirë edhe ato të rrezikshme; në të shumtën e rasteve ato ndodhen përgajtë luginave të lumenjve; pranë disa venddepozitimeve ndodhen puse të vjetra nafte, të cilat ndikojnë në vetndezen e mbetjeve;</p> <p>Reabilitimi dhe mbyllja e sigurt e venddepozitimeve aktuale ka një kosto të larta</p>

	<p>mjedisore; Në të gjitha njësitë e qarkut mungojnë matje të besueshme të gjenerimit të mbetjeve, të dhëna teknike, statistikore, për konsumatorët (informacion i tipit si demografia, turistët, njësitë tregtare dhe të argëtimit, hotelet, etj.);</p> <p>Të gjitha njësitë vendore të qarkut nuk zhvillojnë fusha të rregullta për ndërgjegjësimin e komunitetit;</p>
<b>Mundësítë</b>	<b>Rreziqet</b>
<p>Përcaktimi i prioriteteve dhe objektivat për ndryshimin rrënjosor të sektorit të mbetjeve duke ofruar mbështetje dhe logistikë ndaj NJQV;</p> <p>Planifikimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve nga zona funksionale Shijak do sjellë pritshmëri më të mëdha e mbështetje financiare nga qeveria qëndrore, donatorët, dhe programe të huaja;</p> <p>Harta e vogël e zonës krijon mundësinë të njësitë të hyjnë më lehtë në skema ndër-vendore për ofrimin e shërbimeve të ndryshme të mbetjeve, duke synuar uljen e kostos dhe rritjen e përformancës së shërbimit;</p> <p>Diskutimi në grupe të fokusuara për menaxhimin e mbetjeve është duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve teknike të specialisteve nga çdo njësi në zonën e Shijakut;</p> <p>Nevoja për ndërtimin e një lendfilli të ri shihet një mundësi shumë e rëndësishme për depozitimin e mbetjeve dhe një mundësi e mirë për minimizimin e depozitimeve ilegale në mjedis të hapur;</p> <p>Ka një interes dhe vullnet të shprehur nga komunitetet</p>	<p>Vazhdimi i depozitimit të mbetjeve në fushat e improvizuar përbën një rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut, burimet natyrore (toka, uji, ajri) si dhe për zhvillimin e turizmit në të gjitha njësitë vendore të zonës;</p> <p>Presioni për mbylljen e fushave aktuale për depozitimin e mbetjeve do të krijonte një situatë alarmante për pamundësinë e depozitimit të mbetjeve, për sa kohë që bashkitë nuk kanë të zhvilluar ndonjë infrastrukturë tjetër për trajtimin e mbetjeve;</p> <p>Mbledhja e miksuar e të gjitha rrymave të mbetjeve sidomos me rrymat e mbetjeve të rrezikshme rrit më shumë probabilitetin e përhapjes së ndotjes;</p> <p>Mundësítë e pakta financiare në të gjitha NjQVtë e zonës për shtrirjen e shërbimit edhe në periferit rrezikon shtimin e pikave ilegale/ të hapura të depozitimit të mbetjeve;</p> <p>Pamundësia ekonomike e një shtrese të gjerë të popullsisë së zonës për të paguar tarifat e pastrimit; ndërgjegjësimin i ulët për të paguar, mungesa e mekanizmave për vendosjen e sanksioneve bën të pamundur përballimin e kostos së këtij shërbimi nga tarifat;</p> <p>Mungesa e iniciativave konkrete për riciklimin</p>

<p>Vendore dhe në veçanti nga të rinjtë për nismat vullnetare urbane të pastrimit dhe riciklimit.</p>	<p>apo kompostimin e mbetjeve do të sjellë rritjen e sasisë së mbetjeve, që duhet të asgjesohen në impiantet e trajtimit, duke rritur kështu kostot e transportit dhe të trajtimit;</p> <p>Mungesa e sistemit të diferencuar të grumbullimit të mbetjeve ka konkluduar në aksesimin e një sasie relativisht të vogël të mbetjeve të riciklueshme, ç'ka kufizon interesin e zhvillimit të këtij sektori apo përfshirjen e sipërmarrjeve private.</p>
---	---

### ÷ **Transporti**

Duke qene se projektet e zbatuara ne fushen e transportit në zonën e Shifikut jane mjaft teknike dhe nuk ofrojne një qasje ndaj transportit si sherbim publik, kompetence e njesive vendore grupi kërkimor pa te arsyeshme te vlerësonte situatën edhe në kete fushe. Me kete seksion, synohet per me larg duke analizuar format dhe hapesirat e bashkeveprimit ndermjet njesive vendore per te rregulluar mirefunksionimin dhe menaxhimin e ketij sherbimi. Përfundimet do te hapin rrugen qe analiza të tilla te aplikohen edhe per sherbime te tjera publike ne kuader te decentralizimit dhe bashkeveprimit nderkomunor, si dhe i terheq vemendjen institucioneve vendore per ta pare transportin fillimisht si një sherbim per qytetaret dhe jo vetem si infrastrukture fizike dhe rrugore.

Tabela 10 pasqyron situatën e transportit në të katër njësítë e përgjedhura. Nga studimi ne teresi rezulton se reformat e decentralizimit kane patur një impakt fragmentarizues mbi sherbimin, ku te gjithe operatoret ofrojne standarde dhe kushte te ndryshme, ndersa pushtetet vendore i kane kuptuar reformat ne kendin e ngushte te se drejtes se licensim pa u fokusuar sic duhet ne cilesine e sherbimit. Nga ana tjeter, nderkohe qe nevojitet integrimi i sherbimit ne nivel rajoni, mundesa e bashkeveprimit nderkomunor ne qeverisjen vendore ne rastin e transportit publik nuk eshte eksploruar dhe shfrytezuar sa duhet, ndoshta nisur nga fakti qe nuk ekzistojne udhezimete qarta mbi qasjen dhe strukturimin e ketij bashkepunimi. Konkluzionet e studimit nxisin debatet

mbi integrimin e sherbimeve publike ne nivel rajoni dhe mbi riorganizimin administrativo-territorial te vendit.

Transporti është përshkruar nëpërmjet të dhënave mbi gjatësinë e rrugëve si edhe distancat më të afërta e të largëta nga qendra e njësisë tek qendra e rrethit ose rruga nationale. Gjithashtu edhe numri i linjave të shërbimit urban është përdorur për të plotësuar informacionin mbi transportin.




Tabela Nr. 10 Transporti i brendshëm dhe ndërqtetës, 2014

Gjatësia e rrugëve, km	Distanca më e afërt, km	Distanca më e afërt, minuta	Distanca më e largët, km	Distanca më e largët, minuta	Linja shërbimi urban
Gjepalaj	56	6	3	10	60
Maminas	26	19	15	20	15-20
Shijak	35	12	20	38	40
Xhafzotaj	46	9	25	70	45

Burimi: Studimi, 2014

Nga analiza e informacionit të paraqitur në tabelën 10 mund të konstatohen vetëm disa elementë, ndërsa është e vështirë të krijohet pasqyra e plotë e shërbimit të transportit, dhe akoma më pak, të vlerësohet cilësia e këtij shërbimi. Komuna më e shtrirë, komuna Xhafzotaj, në të cilën distanca ndërmejt pikës më të afërt dhe më të largët, është më e madhe, nuk ka asnjë linjë transporti urban. Gjithsesi të dhënat e tabelës tregojnë qartë se transporti nuk është një faktor ndihme për zhvillimin ekonomik të rajonit. Ekziston nevoja për investime serioze në lehtësimin e transportit.

#### ÷ **Ujësjellës dhe kanalizime**

Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujrave të zeza njihen si të pamjaftueshme/jocilësore dhe përfaqësojnë një nevojë emergjente për përmirësim. Rehabilitimi i rrjetit të vjetruar ujor dhe po ashtu mungesa e trajtimit të mbetjeve ujore janë identifikuar si sfida madhore në disa diskutime të përbashkëta me vendimmarrës dhe partnerë lokal. Megjithëse janë vënë re disa përmirësime të mundësisë për akses në infrastrukturë dhe një vlerësim pozitiv për kushtet lokale në Shijak, uji dhe higjena mbeten prioritete kryesore për pjesën më të madhe të njësive brenda zonës. Shërbimet komunale të ujërave janë decentralizuar dhe janë vënë re disa përmirësime kohët e fundit, por cilësia është ende e dobët. Një tjetër kritikë që vlen të bëhet është eficienca e ulët e shërbimeve komunale me një nivel të lartë të lidhjeve që nuk paguajnë farë faturë uji.

#### *Të dhëna të përgjithshme*

Analiza teknike e shërbimit publik të ujësjellës/kanalizime paraqitet e vështirë, për shkak të pamundësisë për të përdorur të dhëna. Të dhënat relativisht të plota disponohen nga UK Durrës, ndërsa NjQV kanë shumë pak ose aspak informacion. Në zonën funksionale Shijak (Bashkia Shijak dhe Komunat Xhafzotaj, Gjepalaj e Maminas) furnizohet me ujë afersisht 35 përqind e popullsisë, mesatarisht 1,5 orë në ditë. Me përashtim të popullsisë në bashkinë Shijak, në të cilën furnizohet me ujë rreth 76 përqind e popullsisë (nëse konsiderohen të dhënat e popullsisë sipas NjQV), në njësitë e tjera furnizohet me ujë më pak se  $\frac{1}{4}$  e popullsisë (Tabela 1).

Tabela 1 tregon se popullsia e zonës funksionale furnizohet mesatarisht për 1,5 orë në ditë, përkatësisht në Shijak dhe maminas 2 orë në ditë, ndërsa në Gjepalaj dhe Xhafzotaj 2 orë në ditë.

	Ujësjellës	Njësia	Shijak	Maminas	Gjepalaj	Xhafzotaj
1	Popullsia gjithsej sipas Census 2011	banorë	7.568	4.463	3.449	12.381
2	Popullsia gjithsej sipas Zyrës së Gjendjes Civile në NjQV	banorë	13.113	7.200	5.879	18.250
3	Popullsia që furnizohet me ujë	banorë	9.928	1.828	920	3.580
4	Popullsia që furnizohet me ujë (sipas Census)	përqindje	131	41	27	29
5	Popullsia që furnizohet me ujë (sipas NjQV)	përqindje	76	25	16	20
6	Gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë	km	3,7	1,4	1,1	4,1
7	Orët mesatare të furnizimit me ujë	orë	2	2	1	1
8	Familje të lidhura me rrjetin e furnizimit	nr.familje	2200	420	150	1400
9	Gjendja ekzistuese e rrjetit të ujësjellësit e kanalizimeve	e mire/jo e mire	e mire	e mire	e mire	e mire
10	Gjatësia e rrjeteve dytësore	km	13,3	2	1,3	5,9
11	Indeksi i prodhimit të ujit					
12	Indeksi i shijes së ujit					
13	Çmimi për m3	lekë	58	58	58	58
14	Shpenzimet kryesore	lekë				
15	Mbulimi i shpenzimeve në ujësjellës	%				
16	Gjendja e infrastrukturës së UK		e mire	e mire	e mire	e mire
17	Investimet e planifikuar		jo	jo	jo	jo
				Pa kanalizim	Pa kanalizim	Pa kanalizim

Burimi: UK Durrës, Shkurt 2015.

Vetëm 35 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e furnizimit me ujë, përkatësisht në Shijak 75 përqind, në Maminas 25 përqind, në Gjepalaj 16 përqind dhe në Xhafzotaj 20 përqind.

Pervec sa me lart, komunat në zonë perballen me probleme serioze te furnizimit me uje dhe higjenes. Permiresimi i sistemit te furnizimit me uje dhe higjenes perben një nga faktoret kryesore për permiresimin e kushteve shendetesore ne këto njësi. Problemet me kryesore janë: (a) degradimi i rrjetit fizik, (b) mbikonsumimi si rezultat i perdorimit te ujit te pijshem per buqesine, (c) mungesa e kontrollit mbi konsumin faktik perfshire cmimin e ulet te ujit dhe nivelin e ulet te faturimit, (d) institucionet jo te konsoliduara qe merren me furnizimin me uje, dhe (e) mungesa e një strategji per te permiresuar sherbimet. Permiresimet ne komuna lidhen ngushtesish me procesin e decentralizimit, i cili e kalon perjegjesine e furnizimit me uje tek pushteti vendor. Rolli i qeverise në nivel qendror duhet te jetë te siguroje kuadrin rregullator te nevojshem qe garanton pjesemarrjen e organizatave komunitare ne menaxhimin dhe vendimmarrjen ne lidhje me furnizimin me uje te pijshem.

- Faktorë që ndikojnë në në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike në nivel vendor në zonën e Shijakut;

Urbanizimi ka treguar potencialin e ndikimit të vet në zbutjen e varfërisë. Lëvizja gjeografike e krahut të punës, duke përfshirë edhe lëvizjet e popullsisë brenda zones urbane, është një nga mekanizmat rregulluese më të rëndësishme që familjarët që të mund të përdorin të përshtatin të ardhurat dhe asetat e tyre për të përballuar varfërinë, si dhe përshkallëzimin e papunësisë. Ekzistojnë gjithashtu prova të konvergjencës rajonale në

shpërndarjen e varfërisë. Zbutja e ndjeshme e varfërisë në zonat pa ose me akses të vështirë të shërbimeve publike, të cilat janë dhe origjina e shumë migranteve vendas, si dhe numri i të varfërve të papunë janë tregues të përfitimeve nga të ardhurat që vijnë nga emigracioni.

Sipas vleresimit, pjesa derrmuesve e aktorëve vendorë besonin qe cilesia e mesimdhencies ka rene gjate dhjete viteve te fundit, se nivelet e arsimimit kane rene, dhe se po shfaqet analfabetizmi, vecanerisht ne disa vendbanime te reja gjysme-urbane. Shume prinder, mesues, administratore shkollash dhe vendimmarrës kane theksuar qe cilesia e dobet e mesimdhencies dhe nivelet e uleta te ndjekjes së shkollës janë shkaqet kryesore te ketij degradimi. Numri i te regjistruarve ka rene me ndjeshem me perjashtim te nivitet parashkollar. Vendbanimet gjysme-urbane, shpesh te banuara nga te varfer te ardhur nga zonat rurale, jane te paracaktuara qe te kene një nivel regjistrimi poshte atij mesatar (Berryman 2000). Analizat tregojne gjithashtu qe cilesia e shkollave reflekton ne ritmet e regjistrimit, duke e ulur shkallen e frekuentimit te shkolles edhe me tej ne zonat gjysmëurbane.

- **Përfundime dhe rekomandime strategjike mbi qeverisjen dhe zhvillimin ekonomik vendor në zonën e Shjakut:**

Ekziston një hapesire e konsiderueshme per një eficience me te larte te operacioneve kerkimore-shkencore, permes një programi me te pershtatshem kerkimi, permiresim te bashkepunimit ndermjet institucioneve te mbeturë dhe një percaktim te qarte te prioriteteve qe lidhen me kerkimin shkencor, te cilat pasqyrojne nevojat per zhvillim te Shqiperise. Qeveria duhet te mendoje per sistemet e financimit te kerkimit shkencor me orientim nga nevojat, duke perfshire edhe sistemet konkurruese. Eshte me se e nevojshme qe te reduktohet numri i institucioneve kerkimore dhe te konsolidohen ato qe mbeten ne një qender kombetare me një numer te kufizuar degesh. Dissa prej atyre qe duhet te mbeten do te ishin instituti i misrit, foragjereve, grurit, frutikultures dhe blegtorise. Financimi duhet te behet bazuar ne mbulimin e kostove per zhvillimin e farerave mbareshuese ndersa kerkimi shkencor specifik ne linje me priorititet qeveritare, duhet te financohet nga publiku. Prodhimi i embrioneve, farerave dhe vaksinave duhet te transferohet ne sektorin privat. Vemendja kryesore e punes kerkimore duhet te perqendrohet ne pershtatjen dhe futjen e teknologjive qe mund te sigurojne kosto te ulet, zgjidhje efektive te problemeve te fermereve.

Zhvillimi i agro-perpunimit duhet te vazhdoje duke u orientuar drejt investimeve private, ne vend te investimeve te sektorit publik, dhe nuk duhet te kete asnjë perpjekje per te rimekembur thertoret shteterore aspak rentabel, fabrikat e perpunimit te qumeshtit dhe paketimit te mishit. Ne disa raste, si p.sh. ne zonat rurale, bashkia ose pushteti vendor mund te investonte ne ndertimin e thertoreve dhe magazinave frigoriferike, duke i dhene ato me qira bazuar ne parimin e mbulimit te kostos. Nje investim i tille per sektorin publik do te permiresonte higjienen, reduktonte humbjet dhe ulte rrezikun e semundjeve te mbartura nga kafshet. Detyrat kryesore te qeverise do te jene vendosja e rregulloreve transparente dhe te zbatueshme pas konsultimeve te gjera me aktoret ne kete sektor. Investime te metejshme ne aspektin e sigurise ushqimore jane te garantuara, por eshte e nevojshme qe ato te

planifikohen me kujdes ne menyre qe te mos pengojne aksesin gjithsesi te kufizuar rural dhe urban ne produktet bujquesore.

Shqiperia ka mundesi per te eksploruar disa hapesira tregtare bujquesore, si bimet mjekesore, produktet e ullirit, mjalti, produkte te tjera te blettes, djathera dhe mish i tymosur. Megjithate, keto tregje duhet te arrihen te zoterojen ne menyre te qendrueshme. Vecanerisht per bimet mjekesore, zhvillimi duhet te orientohet drejt kultivimit te tyre, sesa grumbullimit te tyre ne gjendje te eger, gje qe rrezikon konsumin e burimeve natyrore. Perpunimi i ketyre barerave ne Shqiperi do ta shtonte vleren e tyre. Qeveria mund te mbeshtese kuadrin rregullator dhe mundesite per eksportim per keto produkte, si dhe te permiresoje shtrirjen e tyre ne kuader te ekstensionit bujquesor. Gjithsesi, funksionimi do te jetë teresisht mbi baza private dhe do te mbetet nje hapesire tregtare me leverdi vetem per nje numer te vogel fermeresh, te cilet do te ngrene biznesin e tyre ne kete drejtim.

Ekonomia rurale varet nga potencialet ne sektorin jobujquesor. Ndersa bujqesia do te vazhdoje te luaje nje rol dominant, vecanerisht per zenien me pune te fuqise punetore, do te jetë e nevojshme te zhvillohen biznese te tjera ne menyre qe te permiresohen mundesite e sigurimit te te ardhurave ne zonat rurale dhe te ulet papunesia. Keshtu, zhvillimi i aktiviteteve me karakter jobujquesor do te jape ndikimin e vet ne flukset migratore dhe mjedisin e per gjithshem te biznesit ne te gjitha fushat, duke e bere lokalitetin me terheqes per sherbime te tjera, por edhe per vete njerezit. Zhvillimi aktual i sektorit jobujquesor eshte ne shkalle minimale dhe ka natyre informale. Ai kufizohet ne ndertimet e dores se dyte (te cilesise se ulet), sherbime te vogla teknike dhe personale. Vetem rreth 20 perqind e ketyre ndermarrjeve jane te shtrira ne zonat rurale. Pavec kesaj, gjate dekades se fundit, ekonomia eshte rritur shume shpejt ne dhe perreth zonave kryesore te uleta urbane, ku perqendrimi i faktoreve te prodhimit ka mundesuar shlyerje me te mire dhe shpejte te investimit.

Nga ana tjeter, zhvillimi i ekonomise rurale jobujquesore ka vuajtur nga nje mungese e theksuar e strukturimeve institucionale, te nevojshme per zhvillimin e tij. Nje program ndersektorial i planifikuar per mbeshtetje dhe inkurajim te investimeve ne funksion te zhvillimit te biznesit, me nje fokus ne ngritjen e kapaciteteve me potencialet ekonomike lokale, do te sherbente shume ne rregullimin e disniveleve aktuale strukturore. Teknologja e informacionit mund te ndihmoje per te lidhur me shume zonat e thella me tregjet, te cilat ato nuk do te ishin ne gjendje t'i arrinin me mjete tradicionale.

Skema konkuruese financimi grant mund te mbeshtesnin nje program me te gjere rural dhe te permbushnin dy kriteret te rendesishme – te menaxhohen ne nivel lokal dhe te imponoheshin nga mjedisi lokal. Per te nxitur zhvillimin e bizneseve rurale me karakter jobujquesor, vemendje duhet t'i kushtohet aspektet kyce te meposhtme:

- a. Ndertimi i kapaciteteve dhe mbeshtetja per sipermarresit ne hapesirat e tyre per prodhim dhe punesim;
- b. Arsimim dhe trajnim ne drejtim te aftesive teknike dhe biznesit, dhe futja e teknologjive me kosto te ulet, te pershtatshme per te shfrytezuar oportunitetet e identifikuara;
- c. Mbeshtetje per zhvillimin e mundesive per biznes dhe instrumentave te tregut per zonat rurale;
- d. Ndertimi i kapaciteteve institucionale ne fushat e pushtetit vendor, organizataave te shoqerise civile dhe sherbimeve financiare rurale; dhe
- e. Permiresime ne disiplinimin e prones, ambienteve institucionale dhe komerciale qe pengojne zhvillimin e biznesit.